

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 249, Korrik 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Kryeministri Edi Rama në Theth

Kryeministri I Shqipërisë, zoti Edi Rama, me datën 30 qershor 20224 ishte ne Theth. Mjaft urime e jo urime pati për këtë vizite të paralajmëruar, madje dhe debate ne faqet e fb, duke e quajtur dhe mashtrues, mjeshtëri i mashtrimit. Dy ditë më parë, historiani, poeti e publicist Prele Milani, do të shkruante: "Zoti Krye mister ardhsh i bardhë, por nuk e duam rrugë të bardhë! Urimi më bujarë shqiptar për mikun është fjala fisnike "ARDHSH I BARDHE!" Po flitet dhe shihen disa lëvizje paralajmëruese për ardhjen e Kryeministrit, z. Edi Rama ne Theth ne këtë fund muaj. Qershori faqe zjarrtë, po ia dorëzon rendin kohor një korriku ende, më rreze ngrohtë. Sipas premtimit publik Kryeministri po vjen te dorëzojë certifikatat e pra te titujve te pronësisë fshatit me hirplote të bjeshkëve tona alpine. Një ngjarje me fort rendësi, po aq e vonuar sa dhe e shume mirëpritur. Edhe ata qe dëshirojnë e luftojnë për rrëzimin tuaj edhe ata që i këndojnë: Tungjatjeta pushetit tënd, kur behet diçka e mirë duhet t'i bashkoj urimi. Të lumtë dora! Regjistrimi dhe certifikimi i pronave të shkatërruar dhe braktisura nga kjo luftë e tmerrshme migruese dhe emigrues duhet vijojë pa ndërprerje dhe me ritëm sa më të shpejtë në çdo fshat të Pese Njësive Administrative te Dukagjinit". Pavarësisht mos besuesve, ajo me datën 30 qershor 2024, u bë realitet. Kryeministri u prit me këngën tradicionale "Majëkrahut", e kënduar nga Ndue Shytani, Fran Kodra e Bledar Jysenaj, dhe me një vadhë nga të rinjtë e krahinës. Pastaj e mori fjalën Kryeministri dhe pas fjalës së tij, filloi të flajë tapitë dhe të paren e filloi me pronën e Kishës së Thethit e pastaj me radhe ...



"Përkujtimorja e Qereshit"

kujtojmë dhe nderojmë Dëshmorët e Planit dhe Dukagjinit

Ditën e hënë më 15 korrik 2024 u organizua nga banorët, në fshatin Plan-Gjuraj të Njësisë administrative Pult "Përkujtimorja e Qereshit". Kjo përkujtimore organizohet që nga viti 1940, në përkujtim të qëndrësës së Planit dhe Dukagjinit kundër okupatorit malazez, ne te cilën ranë heroikisht 81 dëshmorë.

Pas përshëndetjes dhe mikpritjes të të pranishmëve u vendosen kurora me lule, në emër të familjarëve z. Dede Tefa dhe z. Marash Rrethaj, në emër të organizatorëve të "Përkujtimores së Qereshit" z. Fran Rushaj dhe z. Nikolin Gjinaj.

Në nderim të të rënëve u mbajt Një minutë heshtje!

z. Vilson Peshkaj, në cilësinë e moderatorit të veprimtarisë bëri një përshkrim të ngjarjeve të korrikut të vitit 1915 të ndodhura në Dukagjin si dhe mbi rëndësinë, që ka zhvillimi i kësaj përkujtimorja...



Rrugëtim studimor në Kosovë

Nga data 10 deri me 14 korrik 2024 vizitova disa vende historike të Kosovës. Ky lloj udhëtimit ka vlera vetëm nëse dikush që e njih mirë zonën të shoqëron në rolin e njeriut që të shpjegon me vullnet të mirë dhe me pasion. Kjo u mundësua falë mbështetjes krejt dashamirëse të IKMM (Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve) dhe posaçërisht të dy studiuesve të arkeologjisë dhe historisë, të pasionuar të këtij instituti, zotërinjve Qazim Namani e Emin Sallahu dhe mbështetjes dashamirëse të Drejtoreshës së këtij instituti, znj. Rezarta Loxha Vitaku, të cilët nëpërmes këtij shkrimi i falënderoj me për...

DUKE LEXUAR AZEM SHKRELIN ...

E kam lexuar këtë pishtar të poezisë dhe letërsisë Shqipe për kënaqësinë time, por kur disa miqtë e mi më kërkuan të përgatit një studim mbi këndvështrimin tim për ngjyrat poetike të Azem Shkrelit, u ndjeva si një kalores i vogël që do të ngjitet në një mal të lartë. Bjeshkët poetike të këtij meteor janë një relaks dhe frymëzim në vete. Hyra lexova, studiova dhe mbajta shënime nga ylberi poetik i tij pash historinë e palexuar dhe bulëzat e lirisë dhe Pavarësisë të Kosovës, që në fundshekullin e kaluar.



Kryeministri Edi Rama në Theth

Kryeministri I Shqipërisë, zoti Edi Rama, me datën 30 qershor 2024 ishte ne Theth. Mjaft urime e jo urime pati për ketë vizite të paralajmëruar, madje dhe debate ne faqet e fb, duke e quajtur dhe mashtrues, mjeshtër i mashtrimit.

Dy ditë më parë, historiani, poeti e publicist Prele Milani, do të shkruante: *“Zoti Krye mister ardhsh i bardhë, por nuk e duam rrugë të bardhë! Urimi më bujarë shqiptar për mikun është fjala fisnike “ARDHSH I BARDHE!” Po flitet dhe shihen disa lëvizje paralajmëruese për ardhjen e Kryeministrit, z. Edi Rama ne Theth ne ketë fund muaj. Qershori faqe zjarrtë, po ia dorëzon rendin kohor një korriku ende, më rreze ngrohtë. Sipas premtimit publik Kryeministri po vjen te dorëzojë çertifikatat e pra te titujve te pronësisë fshatit me hirplote të bjeshkëve tona alpine. Një ngjarje me fort rendësi, po aq e vonuar sa dhe e shume mirëpritur. Edhe ata qe dëshirojnë e luftojnë për rrëzimin tuaj edhe ata që i këndojnë: Tungjatjeta pushtetit tënd, kur behet diçka e mirë duhet t'i bashkoj urimi. Të lumtë dora! Regjistrimi dhe çertifikimi i pronave të shkatërruar dhe braktisura nga kjo luftë e tmerrshme migruese dhe emigrues duhet vijojë pa ndërprerje dhe me ritëm sa më të shpejtë në çdo fshat të Pese Njësisë Administrative te Dukagjinit”*

Pavarësisht mos besuesve, ajo me datën 30 qershor 2024, u bë realitet.

Kryeministri u prit me këngën tradicionale “Majëkrahut”, e kënduar nga Ndue Shytani, Fran Kodra e Bledar Jysenaj, dhe me një vadhe nga të rinjtë e krahinës.

Pastaj e mori fjalën Kryeministri dhe pas fjalës së tij, filloi të ndaje tapitë dhe të paren e filloi me pronën e Kishës së Thethit e pastaj me radhe ...

Pastaj vijoi me banorin e veçantë, mësuesin në pension, z. Zef Bari, i cili mori dy çertifikata pronësie nga kryeministri Edi Rama. Por përveçse mori titullin e pronësisë iu fal edhe gjoba për ndërtim pa leje. Teksa merrte në dorë titullin e pronësisë, ai u shpreh se falja e gjobave i ka sjell “pajtim” me të shoqen, duke mos i kursyer batutat me kryeministrin. Ai i tha: *“Të përshëndes në emër të familjes time dhe fëmijëve. Na ktheve në identitet, këto 30 vite të fundit na humbi identiteti. Kur i humb identiteti një fshati thuhet se janë të fikur. Ne u fikëm dhe u koritëm, sepse ne nuk dinim se nga vinim. Këtu janë bërë tubime, dasma, janë falur gjakra. Unë kam punuar mësues 45 vjet. Të jam mirënjohës, jam i dënuar për ndërtim pa leje, gjobë 5 milionë dhe gruan time një vit më pas e gjobitën 50 milionë, se kam qenë dakord me nda gruan se më tha e ke bërë ti. Se ajo ka ardhur nga Nikaj-Merturi. Kështu që më ke prurë pajtimin, unitetin dhe të jemi mirënjohës,!”* - u shpreh ai duke shkaktuar të qeshura.

Kryeministri Edi Rama shpërndau 200 certifikata pronësie në Theth, ndërsa batutat pati edhe më një demokrat, të cilit i tha se tapinë ia dha qeveria dhe jo partia.

Madje, Rama i tha se partia e tij desh e ndau Shqipërinë nga Amerika, duke bërë ironi me non gratën e Berishës.

Replikat:

Rama: Mos është i PD ky se këta rri-në gjithmonë në fund edhe thonë Rama ik...I PD është. Mos e diskuto se këta rri-në nga fundi. Mirash unë nuk ika ti erdhe.

Sa më shumë thoni ik, unë vij. Me Amerikën e keni ju, ju deshët me na nda

tha se qeveria dhe Bashkia e Shkodrës kanë gati projektin dhe fondin për të investuar në Theth.

Paketa e maleve është drejt përfundimit, ndërsa gjatë takimit me banorët Rama zbuloi disa prej lehtësive që pritet të sjellë

“Po ndërtojmë program të veçantë për malet që të mund t’u jepet toka, që tu jepet mundësia të ndërtojnë me leje para se të marrin titullin përfundimtar të pronësisë, në marrëdhënie me shtetin, me atë qiranë e famshme 1 euro për të marrë token për



nga Amerika për pak.

S’ta dha partia, ta dha qeveria, partinë mbaje ne zemër, qeverinë në mendje. Me partinë shko fle gjumë, me qeverinë dil në punë.

Të iki unë apo të rri si thua?

Demokrati: Ju keni punë me gjithë shtetin, s’keni kohë me ndej këtu.

Rama: Të thash dorën e majtë t’i të djathtën dhe shkojmë vetëm përpara”, tha Rama.

Teksa ndau 200 certifikata pronësie për banorët dhe njoftoi faljen e gjobave për ndërtimet pa leje, kryeministri Edi Rama

për këtë zonë turistike.

Ndërsa do të vijohet ende me shpërndarjen e tapive, kryeministri lajmëroi se do të ketë lehtësira për të gjithë ata që do duan të investojnë në Theth, të cilëve do t’u mundësohet që të marrin leje ndërtimi ndërsa presin për certifikatën e pronësisë.

Kjo mënyrë shihet nga qeveria si një mbështetje edhe për të gjithë emigrantët që do duan të kthehen për të investuar në atdhe, ndërsa premtoi edhe garanci nga qeveria në rast se do të aplikojnë për kredi.

të ndërtuar dhe ndërkohë vazhdon proceset”, tha Rama.

Ndërsa presin një rritje investimesh, për kreun e qeverisë e rëndësishme është që ndërtimet të jenë të unifikuara dhe të harmonizuara, me qëllim që të ruhen karakteristikat e zonës.

“Karakteristikat duhen ruajtur me fanatizëm, çdo gjë moderne që bëhet duhet t’i respektojë këto elementë. Kërkesa do vijë duke u rritur, do rriten çmimet detyrimisht. Do përfiton ju, përfitim do rritet duke ruajtur me fanatizëm këtë që keni dhe duke i bërë gjërat e



NGA MANIFESTIMI “DITA E PLISIT” EDICIONI XI

Me 22 qershor 2024 u mbajt “Dita e Plisit”, edicioni XI, Plisbardhët u tubuan në ora 10.00 te vendlindja e Miftar Hasanit, në fshatin Panorc, komuna e Malishevës.

Moderatori pasi i përshëndeti të pranishmit me përshëndetjen “Mirë se keni ardhë Plisbardhë”, fjalën ia dha Habib Zogajt, I cili foli për veprimtarin patriotike të Miftar Hasanit, kumtesa e tij u titulli “METEORI I PANORCIT”.

Këngë për Miftar Hasanin, kënduan Naim Salih Krasniqi dhe Salih Bajram Xheliri në truallin e Miftar Hasanit.

Për Miftar Hasanin disa të dhëna i dha edhe studiuesi Hamit Gurguri, i cili kishte ardhur në “Ditën e Plisit” nga Borasi i Suedisë.

Edhe rapsodi Nazmi Hajdari, hodhi disa hipoteza, kush është personi, që ia dha shulin e pushkës Miftar Hasanit...

Studiuesi i veprimtarisë së Miftar Hasanit, z. Habib Zogaj tha, se gjatë punës së librit për Miftar Hasanin dolën disa jo ky jo ai... ia dha shulin e pushkës, kurrë nuk dihet as nuk ka me u zbulua, sepse edhe babës së vet i ka tha “Miftar Hasani, vetëm Zoti dhe unë e ai e dimë!”

Në fund të Pranishmit i përshëndeti, në emër të familjes së Miftar Hasanit, luftëtari e mësuesi Ahmet Rexha.

Pastaj u vijua drejt fshatit Llapqevë, te kulla 300 vjeçare e familjes Hasanaj, në të cilën vijoi edicioni XI “Dita e Plisit”.

Në fillim, rapsodi Nazmi Hajdari këndoje këngën maje krahu “ Mirë se keni ardhur Plisbardhe!”

Manifestimin e drejtoi Ismet Krasniqi – Lala, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe ia dha fjalën përfaqësuesit të Komunës së Malishevës, z. Fatmir Ademaj, drejtor i administratës në komunën e Malishevës.

Plisbardhët u mallëngjyen, kur u këndua kënga me CD e rapsodit Ali Krasniqi “Malli për Isen”, se rapsodi “Is Llapqeva”, i takon familjes Hasanaj

z. Prend Buzhala mbajti kumtesën, e cila zgjoi interesim te Plisbardhët.

Mulla, Xhevat Kryeziu i përshëndeti të pranishmit dhe foli për rendësin e trashëgimisë sonë të pasur me qellim, që Plisi duhet të pranohet në UNESCO si

vlerë e jona kombëtare.

Nga Tirana kishte Ardh një përfaqësi, me përbërje: Agron Isa Gjedia, Shkëlqim Hajdarmataj dhe Nazmi Shima. Të pranishmit u përshëndetën nga Agron Isa Gjedia, organizator[i Festes “Dita e Plisit”,

në malin e Dajtit, në Tiranë.

Fjalë përshëndetëse u mbajt nga Shefki Kadri Slami, i cili organizon Festen e “Plisit Pellazgë”, në Republikës e Maqedonisë së Veriut: si në Tetovë, në Strugë, në Kumanovë e gjetiu.

Januz Mazreku u paraqit me kumtesën “Rapsodët e Llapushës.

Një telegram përshëndetës na vjen nga Presheva nga organizatori I Festës së “Plis Bardh”, z. Xhemaleadin Salihu.

Një fjalë përshëndetës u mbajt nga Shefqet Ademaj Skivjani, i cili ka ardh enkas nga SHBA, në Manifestimin “Dita e Plisit”

Poezitë e tyre, me tematike për “Plisin” I lexuan: Ajet Shala, Sherife Thaqi Berisha, Bekim Kelmendi, Beqir Binishi, e Fazli Ferati...

Në fund të pranishmit i përshëndeten:

Pronari I Kullës Rustem Hasanaj, Drejtori i shkollës së fshatit Aziz Avdia, kryeplaku i fshatit Llapqevë dhe organizatori fantastik, për t’i pritë e përcjellë miqtë, në manifestimin “Dita e Plisit”, z. Qamil Ibrahim.

Në fund u shtrua treveza me ushqime tradicionale, që kishte përgatit nga organizatori Qamil Ibrahim.

Falënderime për komunën e Malishevës për përkrahje.

Falënderim i veçantë shkon për rapsodët Naim Salih Krasniqin e kolegun e tij, Salih Bajram Xheliri dhe rapsodin Nazmi Hajdar, i të cilët e madhështuan manifestimin me këngët e tyre.

Mundësori Media RTV Malisheva

Fotografi: Shkelzen Rexha Nazmi Shima dhe Alban Gashi.

**Ismet Krasniqi Lala,
Kryemoskotjeri
i “Ditës së Plisit”**



Shkrimtari Prend Buzhala duke mbajtur mifjalën e rastit dhe aktori Ismet Krasniqi-Lala



reja të atilla që të jenë cilësore dhe harmonike me atë që kemi”, u shpreh Rama.

Me paketën e maleve, kreu i qeverisë u shpreh se parashikojnë një sistem më të lehtë taksimi, e ndërsa bëri me dije se do të heqin çdo taksë ndërtimi.

“Do bëjmë sistem më të lehtë taksimi. Do paguani TVSH 20% së restorante, hotel, nëse certifikoheni si agroturizëm, duke pasur titullin e pronës ju do paguani një TVSH 6%, tatim fitimit e keni 0 si biznes si vogël. Duam t’iu heqim çdo taksë për lejet e ndërtimi, për çdo gjë, do ju heqim çdo lloj burokracie”, vijoi Rama. Për këtë zonë të veriut, parashikohet edhe ndërtimi i një linje energjetike nga Dedaj, Kopluku, Razma deri në Bogë, që pritet të

zgjidhë problematikën e furnizimit me energjinë elektrike. Ndërkohë, parashikohet edhe mbështetje për të gjithë ata që do duan, që të vendosin panele diellore, por duke ruajtur arkitekturën e zonës.

Nga rruga e Dukagjinit te linja 35 kV, projektet për Thethin destinacion cilësor elitist Drejtori i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Dritan Agolli prezantoi sot paketën e investimeve për atë që ai e theksoi si Thethi i së nesërme, destinacion cilësor elitist turistik. Në takimin me banorë të kësaj zone, ku i pranishëm ishte dhe kryeministri Edi Rama, ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, si dhe kreu i bashkisë ...

“Keni probleme me energjinë elektrike, kemi projektin dhe kemi marrë fi-

nancimin për linjat nga Dedaj, Kopluku, Razma deri në Bogë e më lart. Duhet të gjejmë edhe rrugën e energjisë së rinovueshme. Këtu me këtë diell që është në pjesën e madhe të kohë s’mund të prodhosh energji, të ruhem nga dëmtimi i arkitekturës. Shteti do iu japë mundësi me paketën e maleve që të keni mbështetje dhe lehtësira me panelet që do bëni”, tha Rama.

Ndërhyrje do të ketë edhe në infrastrukturë, me rregullimin e urës së parë teksa futesh në Theth, rregullimi i rrugëve në zonë me gurë kalldrëmi.

Po ashtu, është parashikuar një stacion për mjetet e transportit publik dhe një parkim që do të garantojë më pak trafik dhe sa më pak qarkullim makinash në

zonë. Do të restaurohet qendra e vizitorëve, ndërsa do të shtohet edhe një park lojërash në shkollën e Thethit.

Pritet edhe ngritja e një ‘Ode të Hapur’ që do të shërbejë për panairë me produkte artizanale, treg javor. Lumi do i nënshtrohet pastrimit të inerteve dhe pyllëzimit, ndërsa krye bashkiaku Benet Beci tha, se kanë gati projektin për kanalizimet dhe impiantin për përpunimin e ujërave të zeza.

Rruga e Dukagjinit, sipas kryeministrit Edi Rama do të përfundojë brenda vitit, ndërsa parashikohet bërja e rrugës së Komunit.

**Redaksia e gazetës
“Dukagjini”**

“Përkujtimorja e Qereshit” kujtojmë dhe nderojmë Dëshmorët e Planit dhe Dukagjinit

Ditën e hënë më 15 korrik 2024 u organizua nga banorët, në fshatin Plan-Gjuraj të Njësisë administrative Pult “Përkujtimorja e Qereshit”. Kjo përkujtimore organizohet që nga viti 1940, në përkujtim të qëndresës së Planit dhe Dukagjinit kundër okupatorit malazez, ne te cilën ranë heroikisht 81 dëshmorë.

Pas përshëndetjes dhe mikpritjes të të pranishmëve u vendosen kurora me lule, në emër të familjarëve z. Dede Tefa dhe z. Marash Rrethaj, në emër të organizatorëve të “Përkujtimores së Qereshit” z. Fran Rushaj dhe z. Nikolin Gjinaj.

Në nderim të të rënëve u mbajt Një minutë heshtje!

z. Vilson Peshkaj, në cilësinë e moderatorit të veprimtarisë bëri një përshkrim të ngjarjeve të korrikut të vitit 1915 të ndodhura në Dukagjin si dhe mbi rëndësinë, që ka zhvillimi i kësaj përkujtimorja...

Më pas fjalën e mori z. Lekë Sukaj, i cili në emër të organizatorëve të “Përkujtimores së Qereshit” - 2024 shprehi nderimin dhe respektin për kontributin e dhanë nga vëllezërit e ndjerë Gjesh dhe Pjetër Rushaj. Të gjithë, në këtë ditë të veçantë për Planin e ndjejmë mungesën e shokëve më të mirë, të cilët ishin gjithnjë të pa lodhur dhe bujar për familjen, shokët, Pultin dhe Dukagjinin. Ai i dhuroj vëllait të tyre, z. Fran Rushaj, në emër të organizatorëve të “Përkujtimores së Qereshit” - 2024, “Çertifikatë Mirënjohje (pas vdekje), për z. Gjesh dhe Pjetër Rushaj, “Për kontributin e çmuar në zhvillimin e Njësisë Administrative Pult dhe në organizimin e Përkujtimores së Qereshit”. Më pas, z. Lekë foli mbi nismën e marrë nga familja e Nikë Ndokës së Planit (Familja Rushaj) për rikonstruksionin e Kishës së Planit si dhe për mënyrën e kontributit, që mundet me dhënë secili.

Nga moderatori i veprimtarisë u bë një prezantim me titull “Djali I Planit që i dhuroj jetën Krishtit dhe Dukagjini”, një dëshmi e jetës së At. Gege Lumaj, i dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin “Nderi I Kombit”.

Pas këtyre prezantimeve, veprimtaria vijoi me programin artistik, me te cilin kantautori i mirënjohur z. Fran Kodra, si biri i dhe burri i Planit i këndoj Planit dhe Dukagjinit. Këngëtari i talentuar, mjeshtrë i folklorit, z. Gjovalin Shani këndoj këngën e kushtuar shtëpisë së Nikë Ndokës së Planit si dhe këngë për Dukagjinin.

Kjo veprimtari u mbyll me një dreke me produkte të zonës së Pultit dhe nën shoqërinë e artistëve të lartpërmendur që përformuan direkt.

Me e vogla gjë që, ne brezi i ri e kemi për detyrë, është mirënjohja dhe përlujja me respekt para tyre, ata bënë lufte, ne na lanë detyrë, që ti kujtojmë brez pas brezi.

Dukagjini, Pulti ka mrekulli natyrorë, me bjeshke e kreshta të shumta, livadhe e kullota mahnitëse, lugina e Kirit një nga më të bukurat në Shqipëri. Pulti ka një pozicion gjeografik mjaft të favorshëm dhe të rëndësishëm për zhvillimin e tur-

izmit 4-stinor.

Kultura dhe historia, duke filluar me Dioqezën e Pultit dhe me Principatën e Spaneve janë dhe duhet të jenë, fusha të rëndësishme të kërkimeve dhe hulumtimeve historike.

Kjo veprimtari u organizua me iniciativën dhe kontributin e vetë banorëve, të cilët kontribuuan me shumë bujar financiarisht, fizikisht dhe me prezencë në çdo drejtim. Në emër të organizatorëve të “Përkujtimores së Qereshit” falënderojmë secilin prej kontribuuesve, jemi krenarë për djemtë Gjura - Planit dhe krejt Dukagjinit; falënderojmë Bashkinë Shkodër për mbështetjen e përvitshme që i bën Festës së Qereshit. Të pranishëm në veprimtari, Administratori Njësisë Administrative z. Aleksandër Rroku si dhe Drejtor, Drejtorja e Përgjithshme të Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik Bashkia Shkodër z. Bekim Mema. Mbështesja nga ana e Bashkisë Shkodër është shumë e rëndësishme dhe shpresojmë që të vazhdojë në të ardhmen edhe më e fortë. Mos mbetshin këto troje pa djem të zotët, bujarë e fisnikë.

FALEMINDERIT!

Një përshkrim i shkurtër i ngjarjeve të zhvilluara në korrikun e vitit 1915 në Dukagjin, të cilat do pasqyrohen shumë shpejt në librin e autorit Gjesh Vata.

Mali i Zi i pakënaqur nga vendimet e Fuqive të Mëdha që përcaktuan kufijtë, duke shfrytëzuar edhe brishtësinë e shtetit shqiptar si fillim, sytë i hollu nga Shkodra, të cilën e mori pa vesh tersi. Por ajo që do i siguronte një fitore të qëndrueshme, ishte sigurimi i krahut lindor nga ana e Dukagjinit, duke çarmatosur popullin luftarak të tij, pasi historikisht Shkodrës dukagjinasi i janë gjendur pranë sa here që ajo ishte në rrezik.

Ekspedita e parë ushtarake filloi me datën 2 korrik 1915, e cila përfundoi me disfatën e plote të ushtrisë malazeze të udhëhequra nga gjenerali Nikiç. Me 5 korrik tek Ura e Shalës ushtaret malazez të poshtëruar kaluan të gjunjëzuar nën armët e kryqëzuara të shaljanëve, me premtimin se kurrë më ushtritë e tyre nuk do shkelnin këto anë.

Gjenerali Veshoviç, me të marre lajmin e disfatës në Shalë, menjëherë nisi dy brigade luftarake në drejtim të Dukagjinit, në dy drejtime, nën drejtimin e Mil Spasit njëra brigade u nis nga Mesi në drejtim të Shoshit, duke ndjekur luginën e Kirit, dhe tjera brigade nën drejtimin e gjeneralit Marjan Pasha u nis nga Vraka në drejtim Qafa e Bishkasit - Plan - Shalë. Me qëllim që te godisnin Dukagjinin në dy drejtime, për ta pasur me të lehtë nënshtrimin e kësaj treve, ofensivë, e cila ka

filluar me datë 8 korrik 1915.

Ushtria malazeze e drejtuar nga gjenerali Mil Spasi, me 10 korrik thyhet keqas në Gurë të Kuq dhe detyrohet të kthehet prapa e të vendoset në garnizonin e saj, në Mes.

Brigada tjetër nën drejtimin e Marjan Pashes, pasi kalon Qafen e Bishkasit zbrit në Alavana të fshatit Xhanit, merr



peng Nike Çunin dhe bën përpjekje që të marre peng Ipeshkvin e Xhanit dhe nuk ja arrijnë qëllimit, nëpërmjet të cilit synonin, që pengjet të ishin garanci, për të mos pasur rezistencë të armatosur.

Për ushtrinë malazeze, dëshmitarët okulare treguan më vonë se rruga e T' thoreve të Xhanit ngjante me një gjarpër të zi, që vetëm i dukej koka, por bishti i tij nuk dukej, aq e madhe ishte ushtria në numër.

Në Qafe të Mgulles ishte organizuar rezistenca e parë kundër ushtrisë malazeze nga banorët e Gjinajve e Mgulles, me Toplanasit, të cilët ishin në pozicione bardhore, ndesha më në veri ishin të vendosur Gjura. Edhe pse ushtria malazeze, në krye të kolonës ushtarake kishte vendosur peng bajraktarin e Xhanit, ju afruan kolonës në distancë të mjaftueshme, për të qëlluar dhe Mark Sadria nga Toplana qëllon për vdekje një togër armiq, duke hapur konfliktin, i cili shkoi deri në përdorimin e mortajave 81 mm. Në këtë situatë Marjan Pasha vret Nike Çunin, duke ndezur luftime të ashpra mes dy palëve. Në këto luftime mbeten të vrarë Mark Sadria nga Toplana dhe u zunë robër dy ushtarë armiq, të cilët shoqërohen deri në Shosh si robër lufte, të cilët falen me ndërhyrjen e famullitarit të Shoshit.

Pas rënies së Qafës së Mgulles, në cilin mbeten të vrarë 8 ushtarë malazeze dhe Mark Sadria nga Toplana, Tome Zefi, Prenash Zefi, Mhill Zefi, Gjon Nika e Ndue Nika nga Mgulla; Mirash Gjoni e Gjesh Kola nga fshati Gjura e Nike Çuni nga Xhani.

Me të hyrë në Gjura ata filluan reprezaljet, duke marre të arrestuar Kole Pepen,

që në Qeresh i kërkuan të ndërhynte për t'u ndaluar rezistenca, dhe pas një konflikti të çastit me Gjeneralin malazeze, të cilin e godet me bërryl dhe tenton të largohet, por vritet vetëm disa metra larg nga këtu.

Lufta ndezet e ashpër në çdo drejtim, sa me vetëdije të plote Mark Mirdita, shërbëtor i famullitarit Planit, i cili po vinte nga Malësia e Madhe edhe u lajmërua se në Plan po bëhej lufte mori rrugën drejt Planit nga Qafa e Shtogut dhe në vendin e quajtur Gropa e Strelit ju bashkua Kole Dushes e Ndue Preles dhe pati një bilanc tragjik luftimesh. Këtu mbeten të vrarë Mark Mirdita, Kole Dusha e Ndue Prela, ndërsa nga pala armike mbeten të vrarë 14 ushtarë armiq. Markun edhe pse i vrarë e shpërfytyruan me bajoneta.

Në këto luftime vlen të përmendet qëndresa historike e

Vate Markut nga Gjura, me djali Ndojen dhe nipin Martinin, pasi ju mbaruan municionet, djali dhe nipi vriten jashtë shtëpisë, ndërsa Vat Marku digjet i gjalle që banese.

Luftime të ashpra u zhvilluan në çdo cep të Planit, në Gurte e Mëdhenj, Nderkirza e Kuje e i lbun, ku forcat armike u gjenden të rrethuara dhe në panik të plote pa rrugëdajje. Në këto kushte brigade e Mil Spasit, që ndodhej e vendosur në Mes, tashme e rikofirmuar pas luftës në Gurë të Kuq, nisën nga Mesi në drejtim të Planit për të nxjerre nga rrethimi rreth 1700 ushtarë. Me të mbërritur në Gjura e ndau Brigadën e tij në dy drejtime.

Flaka dhe zjarri mbuloi Planin, nuk kursehen as gra e pleq e deri fëmijë 10 vjeçare. Edhe pas një qëndrese vetëmohuese populli i Planit i ndihmuar edhe nga Shala e Shoshi luftuan me trimëri të pashoqe derisa u shuan dhe familje të tera. Ushtria malazeze doli nga rrethimi dhe në qendër të Planit vendosi para skuadrës së pushkatimit 30 persona, dy nga të cilët arritën të largohen, Stake Mirashi e Martin Kola. Në këtë rast pushkatohen e dhe Paria e Shalës, Mehmet Shpendi, Çun Nika e Marash Delia.

Bilanci ishte tragjik për Planin, që vetëm në një ditë u vranë 44 vete dhe 75 të vrarë ishte bilanci i qëndresës së Planit. Te gjitha shtëpitë e djegur përveç shtëpisë së Nike Jakushit. Të dëmtuar mbeten të mjedhurat e blegtorja e çdo gjë tjetër. Me gjithë atë Plani ja doli të mbijetonte.

LAVDI DËSSHMOREVE TË PLANIT E DUKAGJINIT!

Përgatiti Vilson Peshkaj

Në Shkodër përurohet busti i Kardinalit të parë shqiptar, Mikel Koliqi

Nga Frank Shkreli

Kardinal Koliqi i dënuar mbi 40-vite në burgjet dhe kampet e regjimit komunist enverist, ndër të tjera, në akuza fals, se dëgjonte radio-transmetimet e huaja.

“Kardinali Mikel Koliqi ndër figurat më të ndritura të Kishës Katolike Shqiptare – simbol i persekutimit të katolikëve dhe i popullit shqiptar gjatë regjimit komunist”,- është shprehur Arkipeshkvi Shkodër-Pult, Angjello Massafra, në fjalën e tij gjatë përrurimit të bustit të shtunën që kaloi në Shkodër. “Dëshmitar i gjakut të martirëve derdhur për fe e Atdhe nën rrethana rrëqethëse e tejet tragjike në diktaturën komuniste, ateiste në Shqipëri.

“Ata”, idetë e të cilëve triumfuan kundër së keqes, ishin mijëra e mijëra të pushkaktuarit, të persekutuarit, të burgosurit e të përndjekurit, të vuajturit nëpër kampe komuniste të përqëndrimit, me dekada, siç ishte Kardinal Mikel Koliqi. I dënuar tri herë për pothuaj 40-vjet burg e kampe pune, nga regjimi komunist i Enver Hoxhës, por i mbijetuar i atij regjimi barbar, që robëroi një popull të tërë për pothuaj gjysëm shekulli, ndërsa zhduku nga faqja e dheut ajkën intelektuale shqiptare – mijëra kundërshtarë të atij regjimi ndër më të mirët e Kombit. Por, megjithë vuajtjet e mundimet, idetë e tyre për një Shqipëri të lirë e demokratike, pro-perëndimore, triumfuan, më në fund, kundër të keqes së shekullit XX: komunizmit ndërkombëtar sllavo-aziatik dhe regjimit barbar të Enver Hoxhës, pjellë e keqe e të cilit ishte komunizmi shqiptar.

Një ndër këta të mbijetuar të regjimit komunist në Shqipëri, pra, ishte edhe Mikel Koliqi i emëruar kardinali i parë shqiptar nga Papa Gjon Pali i II, me 26 Nentor të vitit 1994, në Vatikan – “një prift sy pa trembur dhe heroik”, i dalluar për vepra të larta trimërie dhe vetmohimi, citim i Papa Gjon Palit II, nga nekrologjia e gazetës së njohur amerikane, Nju Jork Tajms, me rastin e kalimit në amshim të Kardinalit shqiptar, në moshën 94-vjeçare, me 28 janar, 1997. Mikel Cardinal Koliqi of Albania Dies at 94 – The Neë York Times (nytimes.com)

Ndërkaq, Zëri i Amerikës në gjuhën shqipe, nëpërmjet korrespondetit të saj Pëllumb Sulo, njoftoi nga Shkodra se “Në këtë 30 vjetor të shpalljes së Kardinalit të parë shqiptar Mikel Koliqi, mbrëmjen e së shtunës, në sheshin përpara Arkipeshkvisë dhe Famullisë, “Zoja e Shkodrës” në Shkodër, u vendos busti i tij, vepër e skulptorit Pjerin Kolnika.”

Gjithashtu, Zëri i Amerikës transmeton nga Shkodra se, në atë ceremoni përruruese ditën e shtunë, mori pjesë Arkipeshkvi i Shkodër- Pultit, imzot Angelo Masafra dhe historiania Nevila Nika. Ata vlerësuan “Kardinal Koliqin si një ndër figurat më të shquara të Kishës Katolike Shqiptare, njeriu që u bë simbol i vuajtjeve dhe persekutimit gjatë diktaturës komuniste, klerik katolik, muzikolog dhe

publicist, që u burgos tri herë dhe u dënua me 40 vjet heqje lirie, vite këto që i kaloi në burgjet dhe kampet e punës të regjimit komunist”, theksohet në lajmin përmbledhës të ceremonisë, njoftoi Zëri i Amerikës nga Shkodra.

Kardinal Mikel Koliqi midis Papa Gjon Palit të II dhe Mons Rrok Mirdita, ish-

pra e Kardinal Koliqit ishte dhe është për të gjithë shqiptarët shembull i testamentit shpirtëror e kombëtar. Pra, një udhërrëfyes për të gjithë ne se si duhet punuar, të bashkuar në mirëkuptim për një të ardhme më të mirë për popullin e vendit dhe me një përkushtim me përvujtëri duke kërkuar e përvetësuar gjithmonë

Kujt do ia merrte mendja, para shembjes së Murit të Berlinit, se pas pothuaj një gjysëm shekulli komunizëm, në Shkodër në qytetin e “muzeut të ateizmit” dikur, do ndërtohej busti i Kardinalit Mikel Koliqi, pjesëtarit të një prej familjeve më të njohura anti-komuniste në Shkodër dhe në mbarë Shqipërinë.



Kryepeshkvit të Tiranë-Durrësit.

Kjo ceremoni e mirëseardhur ndonëse e vonuar dhe jo e plotë në shumë aspekte tregon se brezat e shqiptarëve, heronjtë e vet, të vërtetë do i nderojnë dhe respektojnë ndër shekuj, ndërsa diktatorët barbarë të gjitha ngjyrave, sidomos ata komunistë – do harrohen dhe e vërteta historike, do të triumfojë, gjithashtu, heret ose vonë. Urojmë dhe shpresojmë që kujtimi i heronjve të vërtetë të Kombit, siç është kujtesa nëpërmjet ndërtimit të bustit të Kardinal Mikel Koliqit në Shkodër do të frymëzojë brezat e ardhshëm të shqiptarëve për një bashkim dhe bashkpunim më të mirë kombëtar.

“Kardinali Mikel Koliqi ndër figurat më të ndritura të Kishës Katolike Shqiptare simbol i persekutimit të katolikëve dhe i popullit shqiptar gjatë regjimit komunist”, është shprehur Arkipeshkvi Shkodër-Pult, Angjello Massafra, në fjalën e tij gjatë përrurimit të bustit të shtunën që kaloi në Shkodër. “Dëshmitar i gjakut të martirëve derdhur për fe e Atdhe nën rrethana rrëqethëse e tejet tragjike në diktaturën komuniste, ateiste në Shqipëri. Jeta dhe ve-

vlerrat e vërteta e të shëndosha, njerëzore, shoqërore, shpirtërore, kulturore e kombëtare e fetare”, përfundoi fjalën e tij vlerësuese për jetën dhe veprimtarinë e Kardinal Mikel Koliqit, Arkipeshkvi i Shkodër-Pultit, Angjello Massafra.

Kjo ceremoni në Shkodër kushtuar përrurimit të bustit të një prej klerikëve më të vuajtur nga regjimi komunist dhe më të njohur të Kishës Katolike Shqiptare, njëkohësisht, edhe vëllai i Poetit e shkrimtarit të madh Ernest Koliqit, i cili ka vdekur në mërgim si kundërshtar i komunizmit, na bën të besojmë se gjithçka në këtë botë, ndryshon e përtrihet dhe se e mira, kryesisht, triumfon mbi të keqën.

Kjo ceremoni e mirëseardhur, ndonëse e vonuar dhe jo e plotë në shumë aspekte, e të shtunës që kaloi tregon se brezat e shqiptarëve, heronjtë e vet, të vërtetë do i nderojnë dhe respektojnë ndër shekuj, ndërsa diktatorët barbarë të gjitha ngjyrave, sidomos ata komunistë do harrohen dhe e vërteta historike, do të triumfojë, gjithashtu, heret ose vonë. Urojmë dhe shpresojmë që kujtimi i heronjve të vërtetë të Kombit, siç është kujtesa nëpërmjet ndërtimit të bustit të Kardinal Mikel Koliqit në Shkodër – do të frymëzojë brezat e ardhshëm të shqiptarëve për një bashkim dhe bashkëpunim më të mirë kombëtar.



DOLI NGA SHTYPI LIBRI “PYJET DHE SHARRAT E PUKES NË VITE”

(Atje ku kontribuan dhe shumë punëtorë dhe specialistë nga rrethi i Shkodrës)

Disa ditë më parë doli në qarkullim botimi “Pyjet dhe sharrat e Pukës në vite” (Shënime Historike) me autorë: inxhinier Gjon Fierza, ekonomist Pjetër Dema dhe inxhinier Preng Prenga. Autorët janë ish specialistë dhe drejtues të Sharrave të Pukës në disa vite.

Puka, ka qenë e njohur për pyjet dhe industrinë e përpunimit të drurit, që u ngrit pas Çlirimit të vendit. Pyjet e Pukës kanë qenë të njohura dhe kanë kontribuar fuqishëm në rindërtimin e vendit pas luftës së Dytë Botërore, në vitet e socializmit, por dhe në vitet demokracisë e tranzicionit. Me lëndën drusore që është nxjerr nga pyjet e Pukës u ndërtuan me mijëra shtëpi nga ata që shpërngulen nga Puka dhe jo vetëm pas viteve 90-t, në qytetet e zonat fushore të vendit. Pyjet e Pukës kanë zënë gati 10% të fondit pyjor të Shqipërisë. Vlera e produkteve të industrisë së shfrytëzimit dhe përpunimit të drurit në atë ndërmarrje ka zënë 10-12% të vlerës në shkallë vendi. Numri mesatar i të punësuarëve në Ndërmarrjen e Sharrave ka qenë rreth 1500-1700 veta në vit, ndërsa në Ndërmarrjen Pyjore 800-1000 veta në vit. Në pyjet dhe Sharrat e Pukës kanë punuar shumë specialistë e punëtorë përveçse nga Puka dhe nga rrethet: Shkodër, Mirditë, Kukës dhe Tiranë, Lezhë, e të tjera.

Libri ka shumë vlera njohje të aspektit historik e teknik. Ai paraqet dinamikën e fondit pyjor, format e organizimit fuqisë punëtoare dhe të shërbimit pyjor në vite, si u ngritën dhe funksionuan fabrikat dhe repartet kryesore të NPD Fushë-Arrëz deri në vitet 90, por dhe pas viteve 90 deri në vitin 2016.

Në botim përshkruhen problemet e pas viteve 90 dhe gjendje e sotme e pyjeve jo e mirë dhe industria e përpunim drurit tashmë e shuar në atë rreth. Ajo, çfarë ka ndodhur me pyjet në Pukë dhe jo vetëm, tregon për një tranzicion shqiptar, me një qeverisje të dobët ku ligji dhe shteti nuk funksionuan. Puka rrethi më i pasur me pyje, sot është thujse pa pyje prodhues ose ato që janë kanë prodhimtari shumë të ulët. Janë shumë faktorë për këtë gjendje, por faktori “njeriu shkatërrimtar”, është kryesori që gjendja arriti ku është sot. Autorët si njohës të mirë jo vetëm të Pukës, por të sektorit të pyjeve në tërësi kanë propozuar në botim dhe disa masa të menjëherëshme, që duhen marrë në përmirësim të pyjeve në Pukë. Por mbi gjithçka kërkohet ndërgjegjësimi i banorëve vendor i atyre që jetën e kanë të lidhur me pyjet, të mos lejojnë dëmtimin e mëtejshëm të tyre. Strukturat e shtetit

që merren me mbrojtjen e zhvillimin e pyjeve tashme duhet të funksionojnë në çdo Bashki deri në nivel Ministrie.

Pa marrë përsipër të analizojmë këtë botim voluminoz, (çka do jetë objekt i specialistëve të fushës,) u ndala tek disa fakte interesante, që kanë qenë të lidhura me Shkodrën dhe shumë shkodranë nga qyteti dhe fshatrat. Në pyjet dhe sharrat e Pukës kanë shërbyer një numër i madh punëtorësh e specialistesh shkodranë, shumë prej tyre përmenden dhe në botim.

Kapitalistët e parë që patën interes për pyjet e Pukës kanë qenë shkodranë. Si e para sharrë në Pukë është ajo, në vitin 1937 e ngritur në malin e Terbunit. Këtë

ndarjes fatkeqe me Kosovën, ai kthehet në Shqipëri dhe në vitin 1945 emërohet specialist në Sharrat e Kryeziut Pukë. Ai punoi dhe i vendosi sharrat në punë dhe prej këtu u transferua në Llogara- Vlorë, për të vendosë në punë atje teleferikuan. Edhe atë e realizoj me sukses. Kishte filluar eliminimi i intelektualëve sidomos atyre që kishin studiuar në Itali. Atje ju ngrit një akuzë për sabotim në ekonomi. Akuzë që nuk u vërtetua kurrë. Ai u pushkatua nga regjimi i kohës, me 30 shtator 1946. Sot ky rezultat një i dënuar politik.

Në libër përmendet një emër tjetër interesant nga Shkodra, është Rrok Mazrreku (vëllai i dom Nikoll Mazrrekut) me


tu, ekonomia pyjore e rrethit të Pukës, nga viti 1956 -1967 administrohej nga NISH Pyjore Shkodër, nëpërmjet zyrave vartëse të Pukës dhe Fushë – Arrëzit. Drejtuesit e parë, drejtori dhe kryeinxhinieri në ndërmarrje kanë qenë: në Shkodër Loro Beltoja e Pirro Xhumetiku. Ata në shumë vite kanë ndjekur nga afër dhe kanë realizuar pyllëzimet e kodrave të Pukës dhe Fushë-Arrëzit si dhe objekte të tjera të rëndësishme.

Ndër emra të tjerë shkodranë në vitet 1954-1956. përmenden: Vili Mazreku, drejtor i ndërmarrjes, i diplomuar jashtë shtetit para luftës; Adem Mani, infermier i ndërmarrjes, farmacist, i ardhur nga Shkodra; Sul Grethi, furnitor i drejtorisë së ndërmarrjes dhe shofer kamioni GAZ/51 molotov, e të tjerë ...

NISH Sharra – Pukë, në vitin 1961, ishte e organizuar me 5 stabilimente. Në stabilimentin Shkodër, drejtor përmendet Nikollë Babliku, përgjegjës sektorësh Rexhep Mala e Ali Brahim Imeri, inxhinier i përpunimit të drurit Dhori Marjani, teknik makinerie Sabri Vukatana, përgjegjës turni: Myrto Haxhia e Hajredin Halili; brigadier: Avdi Voci, Zef Rudi, Tahir Keri, Shefqet Deda, Muharrem Prizreni, e të tjerë. Veprimtaria e stabilimentit të Shkodrës shtrihej në dy ekonomi pyjore: “Fushë – Zezë” e “Cukal” dhe me një oficinë.

Në maj të vitit 1964, nga N.I.Sh Sharra Pukë ndahen dy stabilimente, duke krijuar N.I.Sh Shfrytëzim Përpunim Drurit në Shëmri (Kukës) dhe N.I.Sh të Letrës dhe Përpunim Drurit në Shkodër, në varësi të Ministrisë së Industrisë. Ndërmarrjes së Shkodrës iu dhanë për administrim stabilimenti i sharrave, që prodhonte rreth 20 mijë m3 lëndë të sharruar në vit, shfrytëzimi i pyjeve në Fushë- Zezë dhe Cukal, fabrika e letrës dhe fabrika e fibrës.

Stabilimenti i sharrave në Shkodër, në vitin 1964 prodhonte: 16 500 m3 trupa sharre, lëndë ndërtimi 2 000 m3, shtylla miniere 6 000 m3, degë vozash 7 000 mst, dru zjarri 30 000 mst, qymyr druri 6 500 kv, friza parketi 800 m3, lëndë e sharruar 23 500 m3 dhe arka ambalazhi 90 000 copë. Drejtor i kësaj njësie ishte Nikollë Babliku, shef plani Vasil Kacelano dhe shef finance Tufik Jukaj. Këtu ndahen Sharrat e Pukës me shfrytëzimin e pyjeve në Shkodër, që fillon organizimi i Kombinatit të Drurit me repartet dhe fabrikat e tij. Në vitin 1967 dhe Ndërmarrja pyjore e Shkodrës ndahet nga Puka, pasi në nivel rrethi krijohet Ndërmarrja Pyjore Fushë-Arrëz.



sharrë e ngritën Taip Ilmia dhe Gaspër Çurçia, që të dy tregtarë me origjinë nga Shkodra. Sharrën e drejtonte vetë pronari Taip Ilmia, si kujdestar dhe të besueshëm për rastet kur mungonte kishte lanë kryepunëtorin Shaban Fishtën.

Në sharrën e Qafë Malit, që u ngrit në vitin 1940, përsëri është pronar Gaspër Çurçia dhe përgjegjës Shaban Fishta. Këta bashkëpunuan dhe me kompani italiane, të cilat dhe ato merrreshin me shfrytëzim të pyjeve në Pukë. Këto ndërmarrje u shtetëzuan deri në vitin 1945.

Pas çlirimit nevojat e vendit ishin të mëdha për lende druri, ndërkohe që sharrat dhe pyjet ishin djegur nga pushtuesit në ikje. Kërkoreshin specialistë për vënie në punë të gatrave dhe sharrave të djegura. Nga shkodranët e parë që shkoi në Pukë mund të përmendim: inxhinierin, doktorin parë i shkencave pyjore shqiptare i lauruar në Fakultetin e Pyjeve të Firences, Benard Laca. Pas çlirimit dhe

detyrën e kryekarpentjerit në Sharrën e Kryeziut. Ai ka një histori të dhimbshme. Ai u akuzua për djegien e stabilimentit në Kryezi, në vitin 1949. Gjykata kohës e shpalli armik i popullit dhe e dënoi me pushkatim Rrok Mazrrekun. Ai u pushkatua hapur para gjithë banorëve të fshatit Kryeziut, që ishin thirrur për të parë këtë ekzekutim pikërisht tek Sharra në Kryezi me 25. 12. 1950 (Ditën e Krishtlindjeve). Nga dëshmitarët e kohës, por dhe nga dokumentet në dosjen e tij, rezultojë se ishte një akuzë tërësisht politike. Ai duhej dënuar si vëllai i priftit Nikoll Mazrreku, që kishte shërbyer disa vite në Kryezi. Atje shkuan dhe jetuan me dom Nikollën, nëna, motra Marie dhe Rroku, i cili punonte kryemjeshtër në stabiliment. Për atë djegieje të stabilimentit u sajua autori Rrok Mazrreku, që u pushkatua dhe dy punëtorë vendas, që u dënuan me burg.

Lidhjet e Shkodrës me Pukën ishin dhe në aspektin administrativ të pyjeve. Kësh-

Rrugëtim studimor në Kosovë

Nga data 10 deri me 14 korrik 2024 vizitova disa vende historike të Kosovës. Ky lloj udhëtimi ka vlera vetëm nëse dikush që e njej mirë zonën të shoqëron në rolin e njeriut që të shpjegon me vullnet të mirë dhe me pasion. Kjo u mundësua falë mbështetjes krejt dashamirëse të IKMM (Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve) dhe posaçërisht të dy studiuesve të arkeologjisë dhe historisë, të pasionuar të këtij instituti, zotërinjve Qazim Namani e Emin Sallahu dhe mbështetjes dashamirëse të Drejtoreshës së këtij Instituti, znj. Rezarta Loxha Vitaku, të cilët nëpërmes këtij shkrimi i falënderoj me përzemërsi për mundësitë që më krijuan për të kryer një udhëtim studimor të suksesshëm.

Këtë udhëtim e kam planifikuar shumë kohë më parë për të vizituar çdo fshat dhe vend arkeologjik të Kosovës, për të plotësuar njohjet e mija që kam nëpërmjet librave dhe dokumenteve arkivore, të arkivave nga vende të ndryshme. Me shumë dashamirësi, personat që përmenda më sipër, më mundësuan që këtë nismë timen ta fillojmë me datën 10 deri me 14 korrik 2024.

Në këto tre ditë hulumtimi, arritëm të kryejmë vizita në këto vende:

E filluam në rrethinat e Prishtinës, në zonën e Gollakut (Galabit) me fshatin Llukar e Markoc, për të vijuar nëpër lokalitetin arkeologjik Obzerik, në fshatin Grashticë (Istrina e hershme), pranë kështjellës dhe lokalitetit Fratishtë, dolëm në kodrinën Stalova ose Bunari i Thatë. Në anën e majtë ishte rruga për Koliq, vijuaam rrugës për Keqekollë, u ndalëm në lokalitetin arkeologjik Konaku i Jonuzit, për të parë vendin ku kishte qenë kisha katolike, e cila ishte rrënuar në vitin 1946, dhe me gurët e kishës ishte ndërtuar shtëpia e kulturës në Keqekolle. Në hyrje të kishës në fjalë ishte zbuluar një pllakë e mermerit me mbishkrim latin, të cilën më vonë e kishin zhdukur. Në fshatin Keqekolle u ndalem tek përroi, i cili lidhet me lokalitetin Glac të fshatit Koliq, atje kur në shekullin XVII, Andrea Bogdani e kishte vizituar kishën katolike. Në këtë lokalitet patëm rastin edhe të shohim skoriet e mbetjeve nga përpunimi i metaleve. Nga shoqëruesit u njoftova se, në çdo prrockë të kësaj malësie hasen skorie

që kishin mbetur qysh nga kohet e hershme të përpunimit të metaleve. Më pas vijuaam rrugën për në fshatin Prapashticë. U ndalëm në lagjen Balaj, në lokalitetin (Berkovica) ku ndodhen vende arkeologjike si Kisha dhe lokaliteti arkeologjik të xhamia e sotme, Gomuri, dhe u njoftova për kodrinat e fortifikuara Suka, Lisina, Makica, Kodra e Madhe (Quka), Konaku i Bilallit, fortifikatat të Dabishevcit dhe qytetin (lokalitetin arkeologjik) në Glllogovicë.



U ndalëm në rrugën, e cila dikur e lidhte Ulpianën me fshatrat e Medvegjës. Nga Glllogovica ka gjurmë të rrugës, që lidhte qytetet Justiniana Prima me Justiniana Sekonda. Këtu ndodhej edhe qyteti i periudhës romake i rangut Polis, dhe tani fusha e këtij fshati nga Polis quhet Polje. Udhëtimin tonë e vijuaam në Krilevë, në komunën e Kamenicës e quajtur Dardana. U ndalem tek xhamia e fshatit, që më parë kishte qenë kisha, te lokaliteti Fratishtë. Aty pamë një varr, i cili ishte sinjalizuar me dy shtylla, që dëshmonin për qytetërimin në kulinën e fshatit.

Nga Krileva shkuam në Strezoc, lokalitet arkeologjik, që e kishte kështjellën dhe kishën e antikitetit të vonë, në vendin e quajtur Vaganesh. Në dalje të Strezocit kaluam pranë kështjellës së fshatit Buxhenice, lokalitet arkeologjik e nga ku ishte sjellë një Pitos, në fakultetin Filozofik të Prishtinës. Kaluam në fshatin

Hajnoc, ku në dalje ishte Kisha paleokristiane dhe kështjella e Hajnocit apo Reqan. Nga aty hymë në Kamenica, pranë kullinës ku është zbuluar stella Dardane me ritin e varrimit. Nga Dardana udhëtuam në drejtim të fshatit Strelica, në të majtë mbeti kështjella në Grizime, ndërsa në të djathtë shkuam tek Manastiri i Moqares. Nga manastiri i Moqares vijuaam rrugës, që shkonte pranë kufirit të Serbisë për tu kthyer në Prishtinë. Kaluam pranë fshatit Kopernicë, lokalitetin e njohur arkeologjik

Novobërda, Monte Novo, Noe Berg e të tjera. Në Marec, mbi hyrjen e galerisë së minierës së Artanes, ndodhej kisha e Shën Martin.

Në kështjellën e Artanës ishte kishë paleokristiane dhe një kishë mesjetare. Jashtë mureve rrethuese të kështjellës ishte kisha e Shënkollit, me kapacitet rreth dy mijë vende, funksionale deri në vitin 1660, sipas dokumenteve nga Arkivi i Propagandës Fide, në Vatikan. Disa qindra metra larg nga kjo kishë, ndodheshin rrënojat e kishës së Shën Mërisë e vlerësuar me kapacitet tre mijë besimtar, e ngjashme me Kishën e Shën Pjetrit në Vatikan, për nga kapaciteti. Udhëtimin tonë e vijuaam në fshatrat Bostan, Makresh e Gjilan ku e përfunduam kërkimin për këtë ditë.

Me datën 13 korrik shkuam në zonën e Mitrovicës, ku në fillim vizituaam Trepçën dhe Muzeun Kombëtar të Kristaleve me eksponate të mrekullive të natyrës së këtij vendi. Vizituaam edhe Kishën e Shën Pjetrit, në StanTërg. Kjo ishte një kishë paleokristiane, nga aty vizituaam edhe njërin nga xhamiat më të vjetra të Kosovës e quajtur Xhamia e Mazhiqit. Afër kësaj xhamie ndodheshin rrënojat e disa kishave katolike. Me këtë rast bëmë një vizitë në shtëpinë e Xhavit Rushitit, një familje e vjetër e kësaj treve.

Objektet arkeologjike dhe të dhënat që më prezantuan specialistët që më shoqëronin ishin për mua një dritare e re, me të cilën unë mund të ballafaqoj dokumentet arkivore që kam marrë në arkiva të ndryshme, me faktet në terren dhe besoj se së shpejti do ju paraqes një kronikë, me komentet dhe këndvështrimin tim, i cili në shumë raste ndryshon nga ato që kam lexuar në botimet e ndryshme të studiuesve shqiptar dhe serb.

Udhëtimin e ndërpreme, për ta vijuar më vonë në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Kosovës, duke mbajtur shënime për çdo objekt historik. Besoj se deri nga fundi i muajit shtator do ja arrij të përmbushi misionin tim, për të vizituar të gjitha vendet me rëndësi historike në Kosovë.

Mark Palnikaj,
Prishtinë me 14 korrik 2024

◀ Teknik investimesh, në vitet 60-70 përmendet emri një shkodrani, Guljem Deda. Më vonë përmendën emra të tjerë specialistësh: Salo Muja, Enver Pajtesa ish k/degës planit, Luan Fishta k/degës financës, Ragip Jacaj e Ruzhdi Tahiri, Shpresa Behri ekonomistë finance, inxhinierët: Myzafer Mandia, Nikolin Noshi, Rrok Gjetja, Zef Pogu, Shyqyri Çoka, magazinier Mark Petrani, e të tjerë. Në oficinë përmendën: Inxhinier Shuajip Duliqi e Brahim Tafa, Nadir Gruda, brigadier Xheladin Dashi, e të tjerë.

NISH Sharra Pukë ka pasur një oficinë me specialistë mekanikë të njohur

në Shkodër: Kolë Prendi, Prend Koca, Skënder Dizdari, shofera Fahri Gavoci, Tonin Ndoja, Nikë Bushi, e të tjerë. Oficina e Shkodrës e ka filluar punën në vitin 1960 dhe ka shërbyer si repart kryesor sidomos për riparime të mesme dhe kapitale, në bashkëpunim dhe e ndihmuar edhe nga oficinat e tjera mekanike të Shkodrës.

Në vitet 1970 - 1990 ka një numër të madh specialistësh të lartë, me origjinë nga rrethi i Shkodrës, që u emëruan dhe punuan në NPD Fushë-Arrez dhe në N. Pyjore të Pukës, inxhinierët: Nadir Gruda, Gaspër Uldedaj, Agim Vorfa, Gjergj Preka, Gjergj Pavaci, Tonin Ndreka, Sk-

ender Halili, Ilmi Hysa, Gjon Fierza, Zeqir Ujka, Arben Cani, Arben Mithi, Kolec Gjeluçi; ekonomistët Shkëlzen Mustafaj, Servete Mesi, e të tjerë. Ishin këto disa emra midis mijëra punëtorëve dhe specialistëve, që kanë punuar dhe kanë kontribuar në pyjet dhe Sharrat Pukës, në gati 90 vite në atë rreth.

Libri ka shumë fakte interesante dhe ka vlerë të lexohet sidomos nga të rinjtë, pasi ata do njihen me një të kaluar kur kishim pyje në Pukë, Cukal, Fushë-Zezë, e të tjera dhe industri të përpunimit të drurit, ku prodhohim jo vetëm dërrase, por fibër dhe letër, kompesato dhe rimeso, mobile dhe lëndë ndërtimi. Në atë industri dhe

ato pyje punonin me mijëra punëtorë.

Duke vlerësuar në tërësi punën e mirë të tre autorëve në këtë botim, po veçojmë njërin prej tyre. Është anëtar i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", djali i Planit, inxhinieri që kontribuoi në pyjet dhe Sharrat e Pukës për më shumë se 11 vite (1982-1993), duke bërë emër të mirë si specialist i zoti dhe si dukagjinasi i vërtetë. Është ky botim si bashkautor, një sukses tjetër i inxhinierit Gjon Fierza, që ju shtohet disa botimeve të tjera të tij me shumë vlera.

Urimet më të mira për Gjonin dhe dy bashkautorët e tjerë të botimit "Pyjet dhe Sharrat e Pukës në vite"!

Ndue Sanaj

DUKE LEXUAR AZEM SHKRELIN RRITET ÇDO POET ...



E kam lexuar këtë pishtar të poezisë dhe letërsisë Shqipe për kënaqësinë time, por kur disa miqtë e mi më kërkuan të përgatit një studim mbi këndvështrimin tim për ngjyrat poetike të Azem Shkreli, u ndjeva si një kalores i vogël që do të ngjitet në një mal të lartë.

Bjeshkët poetike të këtij meteor janë një relaks dhe frymëzim në vete. Hyra lexova, studiova dhe mbajta shënime nga ylberi poetik i tij pash historinë e palexuar dhe bulëzat e lirisë dhe Pavarësisë të Kosovës, që gatuhej në fundshekullin e kaluar.

Kush ishte poeti Azem Shkreli?

Azem Shkreli u lind më 1938 në Rugovë të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa në Prishtinë shkollën e mesme, për të vijuar Fakultetin Filozofik, degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Për shumë vjet ai ka qenë kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, drejtor i Teatrit në Prishtinë dhe themelues e drejtor i “Kosova Filmit”.

Ka botuar këto vepra në poezi “Bulëzat” (1960), “Engjujt e rrugëve” (1963), “E di një fjalë prej guri” (1969), “Pagëzimi i fjalës” (1981), “Nata e papagajvë” (1990), “Lirikë me shi” (1996). Në prozë: “Karvani i bardhë” (1961), “Sytë e Evës” (1975), “Muri i përfundi shqipeve”, “Shtatë nga ata”, si dhe dramat: “Fosilet” (1968), “Varri i qyqes” (1983).

Poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të huaja. Shfaqja e Azem Shkreli si poet, përpos që përputhej me ardhjen dhe talentin e tij të fuqishëm, shënonte njëkohësisht kthesën e parë drejt hapjes dhe modernizimit të poezisë shqipe të pasluftës. Shkreli u ngjiti natyrshëm në kulmet e poezisë së sotme shqiptare dhe këtë vend ai e konsolidoi dhe e përforcoi nga njëra vepër poetike në tjetrën.

Azem Shkreli ishte poet dhe autor/publicist shumë i njohur.

Azem Shkreli zë vend në krye të poezisë moderne shqiptare. Krahas cilësisë, poezia e Shkreli, shënoi kthesë në rrjedhat e poezisë në Kosovë: e zgjeroi spektrin tematik, e subjektivizoi dhe intimizoi heroin lirik dhe çka është më me peshë, solli një ndjesi të re, të mprehtë, ndaj gjuhës, ndaj fjalës. Vargjet e tij hapen dritare

shprese në poezinë Dardane të gjysmës të dytë të shekullit të kaluar, ndryshe nga poezia e viteve pesëdhjetë, të ngarkuar me egon e euforisë kolektive, pa shumë figura letrare dhe stilizime poetike.

Shfaqja e Azem Shkreli si poet, përpos që përputhej me ardhjen e talentit të fuqishëm, shënonte njëkohësisht kthesën e parë drejt hapjes dhe modernizimit të poezisë shqipe të pasluftës. Shkreli u ngjiti natyrshëm në kulmet e poezisë së sotme shqiptare dhe këtë vend ai e konsolidoi dhe e përforcoi nga njëra vepër poetike në tjetrën, deri në atë të fundit, që e la dorëshkrim, “Zogj dhe gurë”, botuar më 1997.

Veprimtaria në poezi dhe në prozë e Azem Shkreli, në fund të viteve pesëdhjetë dhe në fillim të gjashtëdhjetave, shënon kthesë cilësore dhe kthesë në praktikën krijuese letrare. Gjatë viteve pesëdhjetë, si gjimnazist, Azem Shkreli, ka mundur të lexojë nga letërsia e kohës në gjuhën shqipe një poezi tematikisht të kufizuar, me strukturë dhe sajim artistik gjuhësor pa originalitetin e duhur. Ndoshta biblioteka poetike shqiptare e asaj kohe ishte e vogël për fantazinë dhe talentin e tij. Në prozë gjendja ishte edhe më e varfër. Me përjashtim të ndonjë emri, ajo pak prozë e autorëve jo fort të talentuar, kryesisht trajtonte tematikën e luftës dhe të fitores përmes rrëfimit klishe bardh e zi dhe të metodës së realizmit socialist.

Shkreli, shënoi kthesën e parë më të rëndësishme në poezi, në radhë të parë, duke kaluar nga uni lirik intim tek nga ai kolektiv, duke selitur në të temën e dashurisë për vendlindjen dhe duke krijuar imazhin poetik Rugovas, me ngjyrimet e traditës dhe të lashtësisë, dashurinë për vashën, lirikën peizazhiste.

Azem Shkreli mund të veçohet për romanin “Karvani i bardhë” si edhe vëllimin me tregime “Sytë e Evës”, që qëndrojnë ndër më të realizuarat në prozën tonë kombëtare.

Azem Shkreli ishte Shqiptari tipik i Kosovës, ai ishte rritur duke dëgjuar këngët e dragonjve dhe vajin e zanave, duke dëgjuar legjenda dhe histori lufte dhe mbijetese titanike në fshatin Shkrel në bjeshkët e Rugovës, afër Pejës, në perëndim të Kosovës. Rugova ishte biblioteka folklorike e sakrificës Shqiptare për identitet kombëtar.

Ai humbi të emën, kur ishte vetëm dy vjeç dhe u rrit nga gjyshja, e cila vdiq po ashtu kur ai ishte akoma djalë i ri. Megjithatë, ai pati një fëmijëri të sigurt dhe stabile. Pas arsimit fillor në fshatin Nakëll, ai ndoqi shkollën e mesme në Prishtinë prej nga u diplomua me 1961. Ai pastaj vazhdoi studimet në Universitetin e Prishtinës dhe u diplomua, me 1965, për gjuhë dhe letërsi shqipe.

Si student, Shkreli kishte filluar të shkruante për gazetën ditore “Rilindja” dhe

punoi si sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Nga viti 1960 deri me 1975, ai punoi si drejtor i Teatrit Popullor Krahinor në Prishtinë. Për një kohe ai u bë anëtar i trupit ekzekutiv të Shoqatës e Shkrimtarëve të Jugosllavisë. Më 1975, Shkreli u bë drejtor i “Kosovafilmit” – një post ky që e mbajti deri kur u dëbua nga administrata e re serbe, me 1991.

Poeti që jashtëzakonisht i preokupuar për mirëqenien e Kosovës. Ne jemi koshient dhe e kuptojmë më mirë se askush se sa zor ishte të linje gjurmë në borën e bardhë poetike, kur kishe mbi kokë çizmen serbe të realizmit socialist sllav.

Dëshira e tij kryesore ishte t’i përkush-tohej kauzës së të drejtave themelore dhe lirisë së popullit të tij. Ai kaloi një kohë në Gjermani, në vitet nëntëdhjetë, pasi e kishte gruan të sëmurë, e cila kërkonte trajtim mjekësor, gjë që ajo nuk mund ta merrte në Kosovë. Megjithatë, ai vendosi të mos rrinte jashtë vendit me familjen e tij, por të kthehej në Prishtinë, ku jetonte i vetëm. Ky ishte një vendim i rëndë për t’u marrë, por ai ishte i vetëdijshëm se nuk kishte zgjidhje tjetër, pos ta respektonte këtë.

Shkreli punoi pa pushim dhe nuk e humbi asnjëherë nga vështrimi qëllimin e pavarësisë së bashkëkombësve të tij shqiptarë të Kosovës. Tragjikisht, ai nuk arriti të përjetonte realizimin e ëndrrës së tij. Më 25 maj të vitit 1997, ai ndërroi jetë në Aeroportin e Prishtinës, sapo shkeli në tokën e atdheut të tij, në mbarim të një vizite në Gjermani.

Gjithmonë e kam pas bindjen se poetët janë dallëndyshet e para që lajmërojnë pranverën e lirisë. Nëse Rilindja poetike shqiptare lajmëroj pavarësinë e Shqipërisë, mendoj se Azem Shkreli parandjeu, holli në vargje revoltën dhe triumfin e Lirisë për pjesën Dardane të kombit Shqiptar.

Unë e kam lexuar Shkrelin para se të vizitoja Kosovën. Nëpërmjet tij e ëndërova atë që do të gjeja atje. Kur shëtitja atë pjesë të ndarë, atë pjesë të munguar të trungut amtar, në çdo ngjarje dhe veprimtari kërkoja dhe takoja Azem Shkrelin.

Azem Shkreli filloi të shkruante në vitet e hershme gjashtëdhjetë. Vëllimet e tij të para me vjersha “Bulzat”, Prishtinë 1960, dhe “Engjujt e rrugëve”, Prishtinë 1963, trajtojnë kryesisht kujtime nga rinia e tij, por pothuajse nuk kalojnë përtej kësaj si burim frymëzimi. Shkreli i konsideronte këto libra gati si të parakohshëm dhe ushtrime të thjeshta në të shkruar. Ato së shpejti u pasuan nga romani “Karvani i bardhë”, Prishtinë 1961, që u botua në Beograd dy vjet më vonë, i përkthyer në serbisht.

Vëllimi “E di një fjalë prej guri”, botuar në 1970, është përmbledhja e pare, që zbuloi vokacionin e vërtetë poetik që do merrte poeti. Rrezet e para të mëngjesit

poetik të një poeti elitar dukeshin në horizont.

Ndërkaq ishte përmbledhja “Nga Bibla e heshtjes”, që erdhi me 1977, ajo që solli, në të vërtetë, Azem Shkrelin si një kontribuues, mbase më të madh, në poezinë bashkëkohore shqipe, në veçanti të vargut modern nga Kosova dhe si një nga zërat më origjinale. Vëllimet e tjera janë thjesht një konsolidim i themeleve, që hodhi në vëllimin poetik “E di një fjalë prej guri”.

Shkreli shkroi edhe romane, tregime, drama, pjesë teatrore, skenarë filmash, ese dhe përmbledhje letrash – në veçanti “Zoti nuk është shqiptar”, Tiranë 1996. Ai ishte redaktor, autor teksti dhe bashkautor i dokumenteve dhe dëshmime të përmbledhura në “Trokitje në ndërjegjen e Evropës”, në 1992.

Kjo e fundit ishte një botim klandestin i shtypur nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në Prishtinë, anëtar aktiv i të cilit ishte Shkreli.

Përkundër prirjeve të tij të shumta, Azem Shkreli ishte në rend të parë poet gjatë tërë jetës së tij dhe botoi dhjetë përmbledhje poezish nga viti 1960 deri më 1997. Veprat e tij janë përkthyer në serbisht, gjermanisht, rusisht, sllovenisht, maqedonisht, arabisht, italisht dhe anglisht. Në anglisht mori shumë vlerësime, ky vëllimi “Kënga e hutinit”, botuar Prishtinë 1989,

Shkreli, është quajtur “mjeshtër i fjalës” dhe shkrimet e tij kanë pasur ndikim pothuajse të gjithë poetët kosovarë të brezit të ri. Nëse kishte ndonjë kritik, ata ishin te stilit “Dhelpra dhe rrushtë”.

Duke rrjedhur nga “Bjeshkët me Namë”, shkëmbore dhe të egra të Kosovës Perëndimore, Shkreli kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij madhore, jo në atë ambient rural, por në qytetin e Prishtinës. Megjithatë, shumë nga poezitë e tij dalin nga bjeshkët e dashura dhe legjendare të Rugovës.

“...Damar i plasur në trupin tim të bjeshkës. / Atë ditë e sot po kërkoi / Diç të humbur rrjedhave përpjetë. / Gurrë e Martin Bogës, / Dhimbe që rrjedh e kulluar dashurive të mia”

(Nga poezia “Gurrë e Martin Bogës”)

Me kalimin e kohës, ai ishte gjithnjë e më i ndërjegjshëm se. nuk do të mund të kthehej më për të jetuar në këtë rajon, ngaqë kishte nevojë më të madhe diku tjetër. Kosova ishte pjesë integrale e ekzistencës së Shkreli. Ishte themeli i tij i lartë moral dhe ajo kishte përparësi mbi të gjitha angazhimet e tjera. Në një bashkëbisedim të mëvonshme e bija e tij citon të ketë thënë:

“Ne nuk e kemi luksin që të mos bren-gosemi së çfarë do të ndodhë me kombin tone”. Kombe të tjera më të mëdha gjithmonë kishin vendosur së çfarë të bënin me Shqipërinë dhe me shqiptarët. Ata

kishin parasysh në rend të parë interesat e tyre dhe kishin pushtuar tokat shqiptare. Shqiptarët u konsideruan qytetarë të rendit të dytë në shumë vise ku ata banonin.

"A ka vallë fat për kombet e vogla? / Ato hyjnë dhe dalin / nëpër dyer të tragjedive të mëdha"

Shkëputur nga poezia: (Ismail Qemali bej Vlora, Babai i pavarësisë shqiptare)

Azem Shkreli e shihte Kosovën dhe tërë kombin shqiptar me një prioritet të madh dhe askush nuk e dinte këtë fakt dhe nuk e respektonte atë përkushtim më shumë së e shoqja. Ajo ishte një mbështetëse e përkushtuar dhe kritikja e tij më e afërt dhe më e mirë. Ajo jetonte me fëmijët në Gjermani për vite me radhë, për shkak të shëndetit të saj të ligë dhe drejtonte punët e shtëpisë në mungesë të tij. Ai bartte një barrë të rëndë, por asnjëherë nuk vuri në dyshim përzgjedhjen e tij.

Kudo që të ndodhem, do ta mbaj frymën e fundit derisa të shkel në tokën e Kosovës", kishte deklaruar Shkreli:

"...Liria thinjet bukur, nuk plaket, / Kur vdiset, është e pavdekshme, / Kur vdes, i bëjmë vend ne dhe të atdheut / Liria është Kosova, s'kam më fjalë të lirë" (Nga poezia "Lirikë për Lirinë")

Azem Shkreli e shihte vetë Shqipërinë si një mëmëdhe demokratik të të gjithë shqiptarëve dhe përpqej të ruante lidhje kulturore me të sa më shumë, që të ishte e mundur. Megjithatë, ai u shpreh disi i zhgënjyer nga ngjarjet e 97-tes në Shqipëri, këtë kohë dhe shëndeti iu dobësua. Ëndrrat e tij për të ardhmen demokratike të Shqipërisë dhe të Kosovës u lëkundën dhe ai përjetoi një trazim të rëndë emocional dhe zhgënjim. I kapluar nga një ndjenje e fajit dhe pafuqisë, ai të paktën e dinte së ishte munduar shumë ta nxirrte Kosovën nga kanosja e stuhisë, që po vinte dhe së ai kishte përdorur diplomacinë në përpjekje që të ndihmonte Shqipërinë të dilte nga vështirësitë e saj.

Një ditë të bukur pranvere ai i tha së shoqes se e kishte kapluar një mall i madh të "shkonte në shtëpi" dhe ai papritur la Gjermaninë. Mbase ai pati një parandjenjë me stresin tepër të madh, për ta duruar. Ai vërtet priti derisa aeroplani nuk preku token e Kosovës, pas disa orësh, para së ai të nxirrte frymën e fundit.

"Sonte / Qava për ty / Arbëri / Nuk më vjen turp / pse qava / Më vjen turp pse s'munda / Të bëj tjetër / Nga turpi qava" (Nga poezia, "Këngë e turpshme")

Shkreli ishte humanist dhe kishte besim në potencialet e njerëzimit. Ai ruante një optimizëm më të matur. Vetë populli i tij ia çmonte modestinë dhe përunjësinë dhe ai konsiderohej në mase të madhe si "poet i madh dhe si njeri i madh". Një malësor në shpirt, ai i rrinte besnik fuqisë e fjalës:

"fol pak dhe thuaj shumë".

Ai ndiqte traditat malësore të urtësisë, integritetit, mirësjelljes dhe parimeve të Kodit të lashtë të Lekë Dukagjinit, që përfshinte besim apo fjalën e dhënë të besimit, një traditë e ngrohtë e mikpritjes dhe mbrojtjes së të huajve. Si një evropian, intelektual i fundit i shekullit njëzet, ai rrëmonte thellë në çështjet

politike, historike, kulturore, morale dhe shkencore. Ai ishte në gjendje të shihte "vizionin e madh" të shqiptarëve dhe kishte një ndjenjë të mprehtë të historisë së trazuar të Shqipërisë dhe të pozitës e saj të ndjeshme në Evropë.

"Mbi flokë Bizmarkësh, / I bie Europës borë, / Krisma, flamuj të fajshëm / Ngu-lur në një harrim / Një gur nëpër kohë / Shqepon gjënim i gjorë, / Këtu rrjedh gjak, / Epika e popullit tim" (Nga poezia "Përmendore për Mic Sokolin")

Shkreli kishte një afri të ngushtë me poetin Migjen dhe zhgënjimet e tyre, dëshpërimet dhe preokupimet shoqërore, ishin të ngjashme. Ai mëtonte të vazhdon-te luftën e Migjenit kundër shtypjes dhe padrejtësisë.

"...E ngre grushtin Tënd t'fortë për ta thye / Skeletin e sëmurë t'vjeshtës vare mbi ne e kreshta, / Por fryma e fjala pezmit me lidhen nyje. / Dikush po qan. Dhimbja, apo vjeshta?" (Nga poezia, "Me Migjenin")

Duket sikur ai u ndikua në vitet e tij të hershme edhe nga poezia e Martin Camajt, një poet nga Shqipëria Veriore, i

ergji të reja shpirtërore. Poeti i përshtatej emocionalisht ambientit të majave shkëmbore, bimëve dhe luleve alpine, krojeve të ftohta malore, drerëve dhe zogjve grabitqarë, dhe fshatrave të vegjël, banorët e patrembur të të cilëve rropateshin me jetën në peizazhet jomirëdashëse. Rugova ishte në njëfarë mënyre nëna e tij dhe ai ruajti një raport besnik dhe frymëzimi. Kujtime të ngrohta jetësore me gjyshen e tij dhe me familjen e tij të gjerë e vërshonin atë sa herë që kthehej në shtëpi.

"...Po kthehem / E rrepta, e mira / Po kthehem / Përsëri / Po takohem me ty / Si me nënën" (Nga poezia "Rugova")

Lexuesit e Azem Shkrelit ftohen në imazhe kullotash të gjelbra, të qengjat që thithin, te lisat e mëdhenj, te kodrat e veshura me pisha, kasollet prej guri, lahutave, varrtarëve të vrenjtur, kuajve që kullosin, pushkët me strall, plisat e bardhë të veshjes tradicionale shqiptare, qivuret funeralë, veshjet e nuseve dhe tryezat me bukë e kripë. Shtëpia, vatra dhe trashëgimia ishin në zemrën e vlerave të poetit. Zogjtë simbolizonin lirinë, fluturi-

bekime, terma dhe shprehje nga dialekti i Kosovës kishin humbur apo ishin harruar, por ai i ktheu sërish në jetë në faqe të shtypur. Disa nga vargjet e tij do të kup-toheshin sot vetëm nga brezi më i vjetër i malësorëve të Rugovës, por, përmes shkrimeve të tij, këto nuanca do të vazhdojnë të jetojnë. Gjuha shqipe qëndron e vetme në drurin indoevropian dhe ka degën e veçantë. Lidhjet me grekët dhe ilirët përshkrijnë poezitë e Shkrelit. Ai kishte dhuntinë e përshkrimit të dramës të së kaluarës së turbullt të popullit të tij.

"Solli së pari / Ira dhëmbi motit të brishtë / Në teh të saj u mpreh drita / Shkelën akrobate dhe dhembje / Solli së dyti, një kokë / Më e shkurtër jeta e të ndjerëve / Tani preke me thua dhe dëgjo / Gjënim ngjarjesh të vrigëllimta" (Nga poezia "Shpata")

Ndonëse Shkreli rrethohej nga një kulturë dominuese myslimane, ai shkroi edhe për tema të krishtera, siç janë ringjallja dhe shëlbimi. Ai besonte te fisi i tij, tek rrënjët e tij dhe tek ajo që Pashko Vasa e quante njëherë si feja e shqiptarisë.

Përgjithësisht, ai mendonte së Zoti apo zotat i kishin harruar, apo i kishin braktisur shqiptarët dhe së ishte në duart e popullit të tij të siguronte fatin e vet dhe të ndihmonte veten të dilte nga paracaktimi i fatit të tij të zi.

"Erdha këtu / Të më pagëzojnë pa emër. / Erdha këtu / Të më bekojnë pa kurorë. / Erdha këtu / Të më shëlbojnë pa temjane. / Erdha këtu / Që t'i kryqoj dy rrugë. / Erdha këtu, miq / Që t'u lutem njerëzve për Zotin" (Nga poezia "Në Shën Naum")

Ai frymëzohet dhe përcjell emocionin krijimit të tij, jeton kënaqësinë e vargut dhe të vetë poezisë. Duket sikur nga çdo lexues i ardhshëm i tij ai ka vjedh diçka nga bota jonë e brendshme

"Mos shkruani sonete poezi, / As heshtjen si unë mos e shkruani / Ndizeni një varg si qiri / Dhe zjarrin e së pathënës e vuani. / Dëgjoni si dhemb e pathëna, / E beftë, e bukur. Poezi / S'është lot i qiriut as hëna, / Është push i një etje dhe shi" (Nga poezia "Këngë me miq")

Lexuesi dhe bibliotekat kombëtare dhe ndërkombëtare në shqip dhe në gjuhë të huaja tani ka mundësinë t' i shijojë fjalët e këtij poeti të mirënjohur, që lindi në një fole magjike dhe jetoi në një botë të ashpër. Mësoj të ece me zanat, mësoj të flas nga legjendat, luajti vallen magjike të murrllanit rugovas mes gurgullimash ujëvarash dhe përplasje drerësh në dritën e hënës.

U rrit duke lexuar zjarrin që digjej brenda ashtit të shqipeve të plagosura që donin qiellin blu, hapësirat e lirisë të tyre.

Le të jetojë kujtimi i Azem Shkrelit si një gur xhevahir i çmuar, që toka e Rugovës ja fali brezave që të lexojnë dhe të mendojnë shqip nder shekuj



cili jetoi në Kosovë dhe në Jugosllavi për një kohë pas ikjes së tij nga Shqipëria, më 1949. Camaj kishte botuar dy vëllimet e tij të para me poezi në Prishtinë: "Nji fyell ndër male", Prishtinë 1953, dhe "Kanga e vërrinit", Prishtinë 1954, që ishin të frymëzuara nga malet e Veriut të Shqipërisë, ndaj të cilave ai kurrë nuk humbi lidhjen, përkundër viteve të gjata në mërgim dhe pamundësisë e kthimit.

Sikur Camaj, edhe Shkreli ruajti devotshmërinë ndaj së njëjtës kulture malësore. Bjeshkët e tyre i ndante vetëm një kufi i padrejte, por rrënjët i kishin në një trung ishin Dukagjinat Arbnor. Në dalim nga Camaj, Shkreli e kaloi tërë jetën e vet në vendin e tij të lindjes.

"...Më lër dhe pakëz, me lër, Gur i Martinit, / T'ia mbaj dorën në krah si andej në Malësi, / T'ia ftoh shkrumet e mallit e të mërgimit / Dhe do shkoj s'do rrij. / Pse gurët dhe poetët nëpër botë / I dashka të shpërndarë ky dhe i yni, / Zi nuk mbajmë, po kurrë mos qofsh e kotë / Dhembje në Gur Martini"

(Nga poezia "Te Guri i Martinit")

Kthimi në Rugovë i jepte atij gjithmonë ndjenjën e përkatësisë dhe të plotnisë. Ai ndihej pranë rrënjëve atje dhe ishte në gjendje të ripërtërihej dhe të merrte en-

min, trazimin, lëvizjen dhe ndjeshmërinë. Gurët i flisnin atij për përherësinë, qëndrueshmërinë, fuqinë, historinë dhe një kujtim postmortor. Dheu do të thoshte toka e bekuar, atdheu, të ushqyerit, mbi-jetesa dhe paraqiste, gjithashtu edhe atë që ishte rrëmbyer apo që ishte zhdukur – atë që toka mëmë do të thoshte për të mërguarin e përmalluar në diasporë. Me kalimin e viteve, shumë anëtarë të familjes së gjerë Shkreli kishin mërguar në pjesë të tjera të Evropës dhe të Amerikës Veriore

"Lamtumirë në trasta, lamtumirë në ajër, / Në sy lamtumirë... / Koha në dysh po këputet, orë e trishtë po rri / Mbi kokë me sopatë të madhe, / Trupa të avullt të grave, motmote të njoma, / Ofshe të nënave, na pritni, / Le të rriten bimët e fëmijët, etja le ta marrë / Zogun e zërin e krypën."

Vetëm udhët le të plaken, le t'i zbardhet floku / Nisjes sonë, jo kthimit. / Udhë e zeza, gjarpër i gjatë, na hëngre. / Na shpure përtej harrimit" (Nga poezia, "Nisja e mërgimtarëve")

Azem Shkreli kishte një dashuri të madhe për gjuhën dhe qëndiste në një pjesë të madhe poezinë e tij me kuptime të dyfishta apo të trefishta. Ai kënaqej me lojën me fjalë dhe kishte një ndjenjë subtile dhe të butë të humorit. Shumë fraza,

Gjelosh Gjok Rushaj dhe Dukagjini, të cilit i fali jetën!

Me rastin e përvjetorit të vdekjes së Gjelosh Rushaj

Të nderuar pjesëmarrës!

Të nderuar familjar të Gjeloshit!

U bë viti, që Gjelosh Rushaj nuk jeton në mes nesh, por ka jetuar e jeton në zemrën tonë!

Kush ishte Gjelosh Rushaj?

Gjelosh Gjokë Rushaj u lindë me 10 Prill 1972 në lagjen e Thanit të fshatit Plani. Ishte gëzimi i pare, që Zoti ju dhuroj babës Gjokë e nenës Shaqe. Gëzohet kulla e Nikë Ndokës edhe më një djalë, i cili në kujdesin e prindërve dhe atmosferën e një familje të madhe holli shtat, që së bashku me vitet ai, rritej edhe me virtyte, të cilat e bënin të dallohej, që i vogël për inteligjencën dhe maturin.

Fillon shkollën fillore në Planë për ta vijuar në Berdica të Sipërme, pasi familja e tij shpërngulet për një jetë më të mirë dhe për tu dhënë mundësi shkollimi më të mirë. Gjeloshi dhe pse ishte nxënës i mirë nuk arriti të vijonte shkollën e mesme, sepse vinte nga një familje "me problem të kohës."

Në moshën e adoleshencës, falë këmbënguljes së tij arriti të debutoj në radhët e ekipit të peshëngritjes së ekipit të 'Vlaznisë'. dhe falë cilësive e rezultateve arriti të merrte pjesë dhe të renditej në vendet e para. Pas një dëmtimi të rëndë në përgatitjen, për kampionatin e të rinjve detyrohet të tërhiqet nga sporti. Ai së bashku me babën Gjokë, punonin më orare të tejjgjatura marangozë dhe punimet e tyre ishin shumë të kërkuar, në krejt zonën e Dukagjinit, Shkodrës dhe rrethinat e saj. Si djalë i parë i familjes dhe si ishte tradita në Dukagjini, Gjeloshi u fejuar dhe u martua në moshë të re dhe fati e zgjedhe të trokas në një ndër familjet më të mira të trevës së Malësisë së Madhe. Me Florën e Palok Ujkës në Bogë. formojnë një familje të bekuar, që Zoti i gëzoi me tri vajza dhe një djalë.

Gjeloshi zgjodhi të jetoj në Shqipëri dhe tu mbante pleqnimin prindërve dhe të ndihmonte vëllezërit, Pjetrin dhe Franin të ndërtojnë jetë në tyre në emigrim.

Pas rikthimit të Pjetrit nga emigrimi bashkojnë forcat dhe tashmë puna e tyre në fushën e ndërtimit nuk ka kufi.

Gjeloshi edhe pse mjaftë i ri në moshë, por i 'moçëm' në mendime dhe vendimmarrje merr pjesë në disa pajtime gjaqesh e ngatërresash te ndryshme. Ishte për paqe dhe bashkim. Ai në fisin e Nikë Ndokës vendoset përkrah axhëve të tij Mhillit e Kolës edhe në shumë vendimmarrje për të mirën e Dukagjinit.

Gjeloshi, së bashku me vëllain, Pjetrin e të mbështetur financiarisht edhe nga vëllai Frani e kushërinjtë ideojnë dhe realizojnë disa riparime, ndërtime urash e rrugësh. Rivendosin Kryqin e dëshmorëve të rene në qendresën e Planit, kundër ushtrisë Malazezë, në muajin korrik 1915. Punoj edhe për detajet me të vogla, që ky kryq

të zëvendësonte kryqin e mëparshëm i ideuar nga Pader Justin Rrota, baba Gjok e axhët dhe i gdhendur nga Col Nderu i lagjes së Boksit. Kryqi i Ri u vendos në një pedestal guri, për të dëshmuar për brezat që vinë historinë e kësaj qendresë, në të cilën tre dëshmore janë nga paraardhësit e Gjeloshit.



Në shumë iniciativa Gjeloshi dhe vëllai i tij, Pjetri falë edhe besimit, që krejt Dukagjini kishin arritën të bashkonin dukagjinasi në vend ashtu edhe në emigrim dhe mesazhi i tyre ishte të mos braktiseshin Dukagjini, por ti rikthehej jeta. Të mos braktiseshin kullat e të parëve, por të vlerësohej patriotizmi, gjaku dhe munda i derdhur në këto troje. Një nder veprimtaritë përkujtimore ishit dhe 'Përkujtimor-



ja e Qereshit, në të cilën me këmbënguljen e tyre dhe bashkëpunimin Plançorve, ata arritën që ketë 'Përkujtimore' ta kthejnë në 'Përkujtimore' të përvitshme, e cila nga viti në vite filloj të rritjen në pjesëmarrje.

Nëntori i vitit 2022 ishte i kobshëm për Gjeloshin dhe krejt Dukagjinin, që në Përroin e Thatë humb jetën vëllai, Pjetri me djalin Jasonin. Stuhia, terreni i thyer dhe nata e vështirësuan kërkimin e gjetjes së trupave të tyre.

Gjeloshi, edhe në këtë dhimbje mendon për të mirën e tjerëve dhe i kërkon shefit të komisarati Shkodër që të jepte urdhër të tërhiqte forcat policore, ushtarake dhe me qindra banor të zonës dhe të Dukagjinit nga kërkim që të mos rrezikohej jetë e të tjerëve. Në orët e para të mëngjesit së bashku me forcat policore organizon kërkimin e trupave, që pas 2 orë kërkimi gjenden trupat e pajetë. Mes dhimbjes së humbjes së vëllait dhe nipit ai gjen forcë e falënderon Zotin, që mundësoj gjetjen e trupave dhe të gjithë pjesëmarrësit në këto kërkime.

Gjeloshi i premtim Pjetrit se, të gjitha projektet e nisura për Dukagjini do i përfundonte. Pasi kaloi dimri dhe pranvera, ai tashmë me zemër të thyer, por plot force me I realizuar premtimet dhanë Pjetrit, se në bashkëpunim dhe me vëllain Franin, djalin Arildonin, djemtë e axhëve, nipat, miqve dhe dashamirëve arrina të përfundoj rrugën për në qytezën e Boksit, për të cilën në një interviste të dhanë gazetarit Mark Gjeka, ai jep mesazhi: 'Këtij vendit duhet ti rikthejmë jetën dhe mos të lejohet të braktiset!'.

Gjeloshi, me shokët e tjerë dukagjinasi, u bë një ndër organizatorët e dy protestave dhe peticionit për Rrugën e Dukagjinit.

Me 6 Korrik 2023, Gjeloshi po punonte për rikonstruksion e rrugës së Planit, poshtë qytezës së Boksit, në një ndërhim me fugonin e policie ai zgjedh të kaloj vete nga krahun i kundërt, që të mos rrezikoheshin policet dhe duke drejtuar kamionin me zhavorr, duke e pa rrezikun zbrit nga kamioni punëtorin. Shembet bordura mbrojtëse dhe merr me vete së bashku me kamionin dhe Gjeloshin. Ju dha ndihma e parë dhe u dërgua me helikopterin në spitalin Traumës në Tiranë, por lëndimet ishin të rënda dhe në agimin e datës 9 Korrik Gjeloshi ndërroj jetë.

Gjeloshi kaloi në amshim, për tu bashkuar me Pjetrin dhe Jasonin.

Gjeloshi dha jetën duke i shërbyer Dukagjinit, Mesazhi i tij sot jehon në rrjetet e ndryshme, duke përcjellë amanetin e tij 'Dukagjinin të mos e braktisim kurrë, por ta duam dhe ta vlerësojmë'.

Gjeloshi jetoj e punoj, duke dhanë shembullin e mirë të një trashëgimtari të mire i familjes së Nikë Ndokës së Planit.

Ai fali dashuri dhe flijim për prindërit, që e lindën dhe e edukuan.

Ai dha dashuri dhe bashkëpunim me bashkëshorten Florën, që së bashku falënderuan Zotin, për katër fëmijët e tyre, të cilët janë shembulli i mire për prindërit e dashur dhe punëtorë.

Gjeloshi, për fisin ishte prijës i dasmave dhe festave, ja merrte këngës i pari dhe kërcente deri në përfundim.

Gjeloshi, Ishte mik dhe shok i besës dhe fisnik, që motivi i jetës së tij ishte Paqja, bashkëpunimi, vlerësimi dhe mirënjohje për të gjithë.

Besojmë dhe shpresojmë së Gjeloshi së bashku me Pjetrin dhe Jasonin luten, për ne, në lumminin e Parisit.

Për jetën e kontributin e tij, Kryesia e Shoqatës Atdhetare 'Dukagjini', i jep Gjelosh Rushajt, pas vdekjes titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini".

Me motivacion;

"Për ndjenja të larta patriotike dhe kontributin e vjueshëm për rikthimin e jetës normalë në trojet e të parëve të Dukagjinit, me iniciativa familjare ideuan dhe realizuan disa projekte në infrastrukturën e krahinës së Pultit; një nga organizatorët e protestave dhe peticionit për rrugën e Dukagjini në pranverën e vitit 2024, dha jetën aksidentalisht në rikonstruksionin e rrugës automobilistike të Planit"

Të gjithë familjaret, bashkëshortja Flora e fëmijët te rroni e ta kujtoni Gjeloshin tone!

I përvjetshëm kujtimi I Gjelosh Rushajt! Shkodër, me 9 korrik 2024

Redaksia e gazetës "Dukagjini"

TË LUTEM, MOS I PËRGOJO SEKRETET BASHKËSHORTORE!

Jeta bashkëshortore, mendohet e hapur. Karakterizohet nga hyrje, dalje, drika, darka, urime, ngushëllime.

Krahas kësaj hapje, në jetën bashkëshortore, ka edhe gjëra që duhet të mbeten sekret. Secili nga bashkëshortët ka sekretet e veta deri në varr. Dhe, të dy bashkë, kanë sekretet e jetës bashkëshortore të cilat, nuk duhet t'i dijë askush. Kështu duhet të jetë por, jo gjithnjë është kështu.

"Gruaja e ime, i ka treguar nënës së vet se, unë, kam probleme me ereksionin. Momentalisht jam i paafte për seks. Një gjë e tillë më ka bërë të ndihem shumë keq. Më vjen shumë turp që, vjehrra e ime, e ka mësuar se, unë, jam i paafte seksualisht. Më duket sikur të duan tallen me mua. Po vuaj shpirtërisht. Kur e pyeta gruan, pse i ka treguar nënës së vet, ajo më tha: "Unë të gjitha dhe, gjithçka, ia tregoj nënës time".

Mendoj se ajo, gabon shumë rëndë kur i nxjerr sekretet e jetës tonë bashkëshortore...", Demiri, 47 vjeç.

Pse problemet seksuale dhe, ato intime, duhet të mbahen kaq sekret midis bashkëshortëve?

Kjo është një pyetje e cila, duhet t'i shqetësojë të gjithë bashkëshortët.

Gruaja e Demirit, as që e mendonte se, kishte bërë ndonjë gabim. "Hajde tani edhe ti, mos bëj kështu! Asgjë nuk ka ndodhur! Vetëm nëna e ime e ka mësuar këtë gjë, ajo nuk flet me të tjerët", i përgjigjej ajo burrit të vet.

Pse, për Demirin, është problem

kaq i madh, nxjerrja e sekreteve bashkëshortore? Pse nuk duhet t'a dinë të tjerët se, ai vuan nga impotencia?

Pse nuk duhet t'i dinë të tjerët llojet dhe, mënyrat e seksit që, ai, bën me gruan e vet?

Përgjigjeje është shumë e thjeshtë: Demiri, pavarësisht nga situata në të cilën ndodhet, e mendon veten burrë. Burrat, nga natyra, janë programuar që, t'i mbajnë sekret pikat e tyre të dobëta. Askush nuk duhet t'i dijë dhe as mësojë ato.

Kështu janë burrat. Dhe, kanë të drejtë. Ata mendojnë se, kur dikush i mëson pikat e tyre të dobëta, bëhen objekt tallje, përcmimi, poshtërimi në sytë e të tjerëve. Në vend të kësaj, më mirë preferojnë vdekjen. Demiri dhe, kushdoqoftë tjetër, e ka të qartë që, askush nga ata që i mësojnë sekretet e jetës së tij bashkëshortore, nuk është në gjendje t'a ndihmojë. Atëherë, pse duhet t'i mësojnë ata!?

Çdo njeri ka të drejtë të ketë pikëpamjet e veta dhe kufirin e sferës intime private.

Sipas statistikave, gratë, i nxjerrin në masën 82.7 për qind të rasteve, sekretet familjare.

Dhe, pse?

Duket se gratë, nuk e njohin principin bazë të sekretit që: Sekretit, për një mjafton, për dy është i tepërt, për tre, nuk ka më kuptim.

Shumë nga gratë përgjigjen: Më duhet pa tjetër të flas me dikë, nuk e mbaj dot. Të tjera thonë: Bashkëshorti im nuk flet me mua për problemet tona intime. Bisedat me të tjerët janë ventili shfryrës për



mua. Kështu i përligjin gratë lllomotitjet e tyre me të tjerët për problemet intime bashkëshortore.

Gruaja e Demirit e mendonte nënën e vet shoqen më të mirë të cilës, mund t'i tregonte gjithçka. Ndoshta mendon drejt por, kush e garanton se, nëna e saj, nuk ka një shoqe aq të besuar të cilës, mund t'i tregojë gjithçka që dëgjon nga vajza e vet? Nuk ka garanci.

Për Demirin, nëna e gruas së tij, është vetëm vjehrra. Nuk është nëna e tij as shoqja më e mirë dhe, as personi i besuar me të cilin, mund të flasë për impotencën e vet.

Psikologët rekomandojnë që, bashkëshortët, për problemet e tyre intime, në radhë të parë, duhet të guxojnë të bisedojnë me njëri-tjetrin, hapur dhe profesionalisht. Nëse nuk ia dalin, duhet të drejtohen tek njeriu specialist, sipas rastit.

Në asnjë rast, nuk duhet që, problemet e tyre intime, t'i lllomotisin me të tjerët, kushdo qofshin ata.

Është interesant fakti që, shumë bash-

këshortë, pas prishjes së marrëdhënieve apo ndarjes, i deklarojnë luftë njëri-tjetrit. Njëri apo të dy, e sulmojnë njëri-tjetrin me të gjitha mënyrat dhe mjetet e mundshme, jo vetëm për t'a diskredituar në opinion por, mundësisht, edhe për t'a asgjësuar fizikisht.

Sjellje të tilla, janë tipike të kulturës patriarkalo-orientale.

Mjerisht, edhe në kulturën, tonë janë shumë të njohura. I kemi trashëguar nga pushtimi osman. Nuk çlirohemi dot.

Nga momenti që, njëri nga bashkëshortët ia mbyll derën tjetrit, të dy, duhet të mbyllin gojën për njëri-tjetrin. Mund dhe duhet të flasin vetëm para njeriut profesionist dhe organeve gjyqësore. Me askënd dhe, në asnjë rast tjetër.

Nuk ka njerëz më të pa logjikë, se bashkëshortët të cilët, kur ndahen, nuk lënë gjë pa shpifur dhe përgojuar për njëri-tjetrin.

LEKE IMERAJ,
përkthyes, shkrimtar e publicist

Nënkolonel Martin Gjoni u nda nga jeta

Me datën 19 korrik 2024, në vendlindjen e tij, në Fushë Kuqe të Gurzit u varros N/Kolonel Martin Gjoni, në mshen 63 vjeçare

(fjala mortore)

Për ju Çile, bashkëshortja e Martin!

Për ju Suela e Bjanka, vajzat e Martin!

Për ju Prenda e Marija, motrat Martin!

Për ju Marku, Rroku e Gjovalini, vëllezërit e Martin!

Për ju gjaku i dajës Gjon Preka!

Për ju miq, shokë e koleg të Martin!

Për ju pjesëmarrës në këtë ceremoninë mortore të Martin!

Sot jemi mbledhur për ti dhënë lamtumirën e fundit N/Kolonelit në rezerve Martin Gjoni, që arriti me na mbledh të gjithëve bashkë, por është hera e pare, që Martin na "tradhton të gjithëve njëherësh!

Kush ishte N/Koloneli në rezerve Martin Gjoni?

N/Kolonel Martini ishte nipi i Gjon Prekes së lagjes Than, të fshati Plan, me një urti e patriotizëm të pashoqë, që vetëm në qëndresën e Planit, kundër ushtrisë Malazeze, në muajin korrik 1915 dha tre dëshmorë.

Martini, lindi me 24 maj 1961, në Fushe Kuqe, fëmija i gjashtë i Lulash e Katrina Gjonit.

Martini kreu shkollën 8 vjeçare në fshatin e lindjes, vijoi shkollën e mesme të përgjithshme "Skënderbej". Me përfundimin e shkollës së lartë të oficerëve, në vitin 1982 fillon punën në detyrën e shefit të shtabi të batalionit të këmbëtorisë në shkollën e Lirë, te Ura e Mesit në Shkodër. Për aftësitë e tij drejtuese, organizuese e komunikuese emërohet në detyrën e komandantit të batalionit të këmbëtorisë, në rajoni i Gështenjave, në Grudë të Re dhe më vonë në detyrën e Instruktorit të përgatitjes fizike

në shkollën e instruksionit për oficeret rezervë, në Vau Dejës deri në detyrën e komandantit të kësaj shkolle.

Në vitin 1997 emërohet në detyrën e Shefit të Komisarariatit në Shkodër, i cili dha një kontribut të jashtëzakonshëm në vendosjen e rendit në qytetin e Shkodrës dhe rrethinave të tij. Po në këtë vit, për motive politike të kohës u largua, së bashku me familjen, për në Itali.

Martini, në vitin 1985, me mësuese Çilen, e bija e Zef e Mara Ucit nga fshati Vukel i Kelmendit, formojnë familjen, që patën tre vajza: Marcelen, e cila u nda shpejt nga jeta, Suelen e Bjanken, të cilat i kanë shkolluar deri në nivelet më të larta dhe sot janë në punën e tyre të pavarur.

Martini ishte një veprimtar i palodhur, në veçanti për çështjen shqiptare. Për shume vite mbajti detyrën e Kryetarit të shoqatës "Vllaznimi" – "Fratelanza", në Vicenza. Me punën e tij, ndihmoi shumë në nxjerrjen e publikimin e vlerave të shqiptarisë, organizoi shumë veprimtari artistike e kulturore, me artistë të njohur shqiptar.

Martini ishte punëtor i palodhur në realizimin e ëndrrave të tij. Ishte i pa kursyer për të ndihmuar familjen e të afërmit e tij, miq e shokë.

Martini i jone u nda nga jeta në moshën më të mirë, për të cilin të gjithë kishim ende nevojë të komunikojmë e të marrim prej tij këshillat e nevojshme për jetën e punën, në mënyrë të veçantë bashkëshortja Çile, vajzat

Suela e Bjanka, vëllezërit Marku, Rroku e Gjovalini, motrat Prenda e Marija, djemtë e vajzat e axhave Kola, Ndoci, Tonini, Agimi, Gjoka, Gjostja, Liza e Vera, të gjithë të afërmit e gjaku i Gjon Prekes, Por kjo është jeta, për të cilën duhet me gjete forca për ta përbaluar si të vijë, mos me u ligështua e me ece, se ndryshe nuk mundet të përbalohen fatkeqësitë.

Martini u nda nga ne, për të mos vdekur kurrë me jetën e veprën e tij ndaj familjes e atdheut, Ai mbeti i gjallë në mes nesh, në zemrën e secilit nga ne!

Prandaj në emrin tim dhe në emrin e kolegeve të tij: Kolonel Et'hem Bardhi, që ndodhet në mes nesh; Kolonel Flamur Muçes, Vuksan Vukes e Gjovalin Shytit, Gac Matia, Lefter Shehu, Odise Vasili, Rafael Caka, Tonin Dodani, Myzafer Mustafa, Tome Preka, Besnik Gjonbrati, Zef Bugaçeja e shumë të tjerë koleg të Martin, ngushëllojmë gjithë familjen e madhe të Gjon Prekes, në veçanti të Lulash e Katrina Gjoni, bashkëshorten e tij Çilen e vajzat Suelen e Bjanken: Martini ju paste lanë jetën, mbarësinë e mirësinë në jetën tuaj!

Martin Gjoni dheu i Fushë Kuqes, i vendlindjes tende të qofte i lehte!

I paharruar kujtimi i N/Kolonel Martin Gjonit!
Lamtumirë kushëri e koleg i dashtun Martin!

Ndue Sanaj,
Fushë Kuqe, me 19 korrik 2024



Misteri i Atlantidës

Studiuesi AGRON LUKA para se të ndahej nga jeta, me 13 qershor 2024, pati dërguar për gazetën “Dukagjini” artikullin “Misteri i Atlantidës”. Në respekt të punës së tij, po e botojmë këtë artikull, që na duket mjaft interesant.

Sipas mitologjisë së lashtë pellazgo-ilire, “Plaku i Detit”, Nereu, që jetonte bashkë me të bijat nereidat e oqeanidat, në një shpellë nënujore të Detit Jon, e dinte “Sekretin e rrugës për te Atlanti dhe Atlantida, në fund të Tokës në Perendim” dhe ishte ai, që ia tregoi këtë rrugë eksploratorit Herakli ...

Mitologjia dhe autorët antikë për

Atlasin dhe ishull-kontinentin Atlantida

Në një emision të fundit shkencor televiziv, të titulluar “Në kërkim të Atlantidës”, hidheshin disa hipoteza se ndoshta Atlantida duhej kërkuar në hapësirën ishullore vullkanike mesdhetare, si në Kreta, madje deri edhe në Trojën e famshme e të tjera. Ndër hipotezat candidate ka pasur supozime edhe për ishujt Britanikë, për ishujt vullkanikë të Kanarieve dhe Azoreve, për një zonë në Meksikë e të tjera. Duke u bazuar tek Platoni se Atlantida ndodhej përtej “Shtyllave të Herakliut”-Gjibraltarit, hipoteza më e fundit, të cilës i kushtohej edhe pjesa më interesante, kërkonte të demonstronte se Atlantida dhe kryeqendra e saj mund të kishin qenë edhe në hemisferën perendimore, në kontinentin amerikan. Atje janë gjetur edhe rrënojat arkeologjike të një qyteti “me mure të larë në ar” dhe të një perandorie gjigande e të tjera.

Sipas mitologjisë helene, e cila kishte përvehtësuar e rregulluar edhe nga mitologji më të lashta egjiptiane, asiro-babilonase, fenikase, pellazge e të tjera, Atlanti/Atlasi ishte bir i Japetit dhe i një Oqeanine (Klimenes ose Asia në një varjante tjetër). Atlasi, i rracës së gjigandëve, kishte tre vëllezër Menezin, Prometeun dhe Epimeteun. Një varjante tjetër e sjell Atlasin si birin e Uranit, dhe vëlla me Kronin, pra si xhaxhai i Zeusit. Kur Zeusi i shpalli dhe e fitoi

luftën ndaj gjigandëve, Atlasin e dënoi të mbante “globin qiellor në fund të botës në perendim”, diku atje te Gjibraltari e te shkretëtira marokene. Po atje, me sa duket e kishte “internuar-dëbuar” edhe bazileusin e lashtë Gerionin e Trefishtë të Epirit me kopetë e tij, madje e kishte ngarkuar të ruante edhe Hesperidat e Bukura, Pemën e Hesperideve me mollët e arta, atje kishte edhe një gjarpër tinzar. Po ashtu edhe Prometeun e famshëm, që ua vodhi zjarin perendive për njerëzit, Zeusi e dënoi të lidhur në një majë shkëmbore në Kaukaz, ku një shqiponjë i hante mëlçinë. Njihet pastaj mitologjia, se si Herakliu shkoi të vizitonte Atlasin, se la si shenjë “Shtyllat e Herakliut” në ngushticën e Gjibraltarit e të tjera. Në mitologjinë helene njihet ideja se duke shkuar nga perendimi arrihej në lindje! (Shih, P. Grimal, “Enciclopedia dei

miti”, 1990, fq. 80 e të tjera).

Ish mitologjite e hershme, të përziera edhe me dijenitë më të hershme gjeografike njerëzore u reflektuan të shkruara edhe në një varg autorësh të mëvonshëm antikë, si edhe në arte të tjera, sikurse vërtetohet nga shumë zbulime të objekteve arkeologjike. (shih figurat)

Është thënë se vepra “Odiseja/Uliksi” e Homerit realisht, ishte edhe një lloj hartë detare mesdhetare, në të katër kordinatat. Aristoteli më vonë do t’ua përkufizonte: se në saje të hegjemonizmit helen, koloni-qytetet helene kuaknin, përreth detit Mesdhe, si bretkocat rreth një pellgu.

Detarët ilirë e dinin rrugën që të çonte në Atlantidë!



Në temën e Atlantit dhe Atlantidës, në mitologjite e lashta të gadishullit Evropa, një vend zënë edhe teritorët e popullsitë iliro-epirote, madje një vend edhe me pikë-nisjen e eksploratorit Herakli! Dhe të vjen mjaft hidhur që kjo temë, sado e modës mitologjike, nuk duhej lënë në harresë nga autorët tonë dhe as në errësirë e fund detit, për mungesën e kërkimeve arkeologjike nënujore.

Nga Apollodori (shekulli II p.e.r.) nxirret informata se Herakliu fillimisht, kur doli nga Argosi, nuk e dinte rrugën që të çonte te gjigandi Atlasi, i cili “mbante sferën qiellore, në fundin e botës në Perendim”. Me këtë preokupacion, ai erdhi me rrugë tokësore në Iliri dhe këtu mori një informatë nga nimfet lumore ilire, që jetonin në një shpellë diku andej pranë Epidamnit. Të kujtojmë “Shpellën e Pël-

lumbit”, “Shpellën e Zezë” afër Tiranës. Të kujtojmë se vetë Epidamni-Dyrahioni, pas v. 627 p.e.r. ishte si Hong-Kongu i antikitetit! Vetë legjenda mitologjike e Epidamnit na sinjalizon për ekzistencën e një qyteze-qendre detare edhe më përpara se të instaloheshin aty kolonistët nga Korinti, Korkyra dhe Dorida e Peloponezitet. Në po këtë legjendë na del me pjesmarrje edhe vetë Herakliu. (Etimologjia, “Sipër Demi, Rrashtë/Koka e Demit”? Sipas linguistëve evropianë, miratuar edhe nga Çabej, St. Etim. III, 1987, fq. 190-192, te Epidamn dallohet etimoni “damn/dem” i ilirishtes së lashtë. Edhe paraqitja hartografike na jep pamjen e një koke demi!)

Dhe të kthehemi te rruga e Atlantidës. Nimfat lumore ilire i thanë Herakliut se

se në Ishullin Skeria/Korfuz kishte porte, shkollë lundrimi, kantjere anijendërtuese dhe se detarët feakas të Korfuzit i binin kryq e tërthor detrave deri në fundet e botës. (“Mbi të tjerët nart të lundrimit shquheshin feakasit.../ nam kishin si lundërtarë të aftë/ zotër lundrash, detarë me rrema të gjatë.../kryq e tërthor detrave u binin/ ...” Odiseja, 1976, VIII; XIII, e të tjera). Sipas disa autorëve antikë, Korfuzi qysh më përpara se shekulli VIII p.e.r., dmth përpara atij që quhet si “kolonizimi i madh korintian”, kishte qenë një bazë detare me një dominim iliro-epirot dhe që ia kalonte si traditë e flotë detare edhe vetë Korintit. Ka mjaft pika të supozohet se detarët jonikë epirotë kishin përvehtësuar edhe mitologji nga kontaktet e tyre direkte me navigatorët fenikas e egjiptianë, të cilët ishin ngjitur deri në Jon-Adriatik, në importimin e mineraleve, sklevërve, mjaltit e dyllit për mumifikimin e të tjera. Herodoti e pohonte se fenikasit i kishin shitur tempullit të Zeusit të Dodonës dy priftëresha të zeza dhe se ky tempull profetizonte njësoj si tempulli i Tebës së Egjiptit. (“Historiae”, IX.)

Përsëri nga Apollodori informohemi se diku nga Egjipti dhe nga Arabia, Herakliu

nuk e dinin atë rrugë, por megjithatë i dhanë informatën se vetëm Plaku i Detit Nereu, i cili jetonte në një shpellë nënujore detare diku nga bregdeti i Jonit bashkë me të bijat nereidet e oqeanidet, e dinte sekretin e asaj rruge. Herakliu shkoi atje dhe vetëm pasi e shtrëngoi me forcë Nereun, arriti t’ua mësonte nga ai intinerarin e asaj rruge. Ai duhej të kalonte ngushticën e AkroKaravës (Anija e madhe feake si një vargmal lartë i ngurrosur, Akrokeraunia, sipas mitologjisë së Homerit. Këtu, ngushtica e Japigjisë/Otrantos. A.L.), pastaj të lundronte brigjeve të Sicilisë dhe në pikën më të afërt duhej të hidhej në Libi dhe që andej të shkonte te Oqeani Perendimor Atlantik, nga ku mund të arrinte te ishull/kontinenti i Atlasit. Kujtojmë se Homeri e përmend Nereun (ose Forkyni) dhe gjithashtu nënvizon

mësoi se atje dinin edhe disa rrugë të tjera me të cilat kordinatat tokësore përshkoheshin duke u imbarkuar në një “Kupë Fluturuese të Diellit”. Me këtë kupë mund t’i bihej tokës, në të katër kordinatat, madje mund të shkohej edhe te Hiperboreanët veriorë etj. Llogjika të shtyn të mendosh se këto ide, sado realizime dëshirash njerëzore me fantazi, bazoheshin jo vetëm te toka e sheshtë me katër kordinata, por diku-diku edhe te toka glob. (Apollodori, “Bibliotheca”. Lib. II, 114 etj; shih më hollësisht Grimal, cit. f 231-232 dhe fq. 442-443 e të tjera).

Një informatë interesante jep edhe Didori i Sicilisë, i cili shkruante se, Pirrua i Epirit, mbasi i kishte mundur kartagjenasit duke ua marrë pothuajse të gjitha portet e Sicilisë, kishte grumbulluar një flotë

të madhe. Pirrua, nënvizonte Diodori, synonte të hidhej nga Siçilia për të pushuar Libinë, duke “ndjekur gjurmët e Herakliut”. (Exerpt. Hoeschel, fq. 497-499, cit, sip. “Ilirët dhe Iliria në autorët antikë”, 1965, fq. 146-147) E njejtë thënie “për ndjekjen e gjurmëve të Herakliut” ishte përdorur edhe për Aleksandrin e Madh, por në drejtimin e kundërt nga lindja. Në dokumentin e zbuluar në “Statutet e Shkodrës”, në vitin 1997, “Testamenti dhe Privilegjet dhe Aleksandrit të Madh dhënë popujve ilirikë”, na del shprehja: “Aleksandri i Madh, biri i Zeusit, Zot i Tokës prej ku lind e ku perendon e nga veriu në jug” e të tjera. (Shih shkrimin tonë botuar i shkurtuar nga red. “Koha Jonë”, date. 18-19 shtator 2006 e të tjera). E këtu na duhet të shënojmë se, dinastia e parardhësve të Aleksandrit të Madh e mbante veten me prejardhje nga Herakliu. Në një rast Aleksandri u mburr disi se, ja kishte kaluar deri edhe Herakliut, me arritjen e tij në Indi. Dhe ishte e kuptueshme simpatia dhe mburrja me Herakliun, në gadishullin tonë; me këtë eksplorator tokësor, navigator detar dhe fluturues ajror; me këtë ndërtues qytetesh dhe muresh fortifikuese; me këtë mbrojtës të njerëzimit, i

arrin deri atje detyroheshin të shtyheshin akoma më thellë Dhe kështu ngjau me sa duket edhe me “perendimin e diellit në fund të tokës”, i cili u shty edhe përtej brigjeve afrikane në Oqeanin Atlantik. Sipas përshkrimeve të Platonit, ishull-kontinenti gjigand i Atlantidës na kishte pasuri të mëdha bujqësore e blegtorale dhe sidomos pasuri mineralogjike, si ar dhe në një lloj metali “orikalku”, i cili shkëlqente si zjarr, kishte një qytet përrallor të rrethuar me mure të larë me ar, me tynele nëntokësore, me kanale të lundrueshme, ku vlonte tregëtia. Atlasi ishte mbreti i këtij vendi, një njeri i ditur me njohuri astronomike e të tjera. Nisur nga fakti se kjo informatë vinte nga Egjipti, shumë studiues mendojnë se ndoshta detarët egjiptianë dhe fenikas kishin arritur ndonjë farë komunikimi e dijenie për brigjet e kontinentit amerikan dhe qytetërimin e atjeshëm. Nga mitologjia dhe nga navigimet e fenikasve sot njihet se ata lundëtarë të famshëm e kishin pagëzuar më përpara ngushticën e Gjibraltarit si “Shtyllat e Melkartit” dhe se ata kishin lundruar thellë edhe përtej këtyre shtyllave, përgjatë brigjeve afrikane. Zbulimet më të fundit arkeologjike kanë nxjerrë ekzistencën reale të ish

dhe “Zbritja në Hënë”, në shek II-të!

Shkrimtari grek Lukiani (shekullit II), i cilësuar si “Volteri dhe Zhyl Verni i antikitetit”, duke sintetizuar një paraqitje të dijetarëve e filozofëve helenë, që shkonin shumë kohë para Erës së Re, shkruante: “Duke vënë re gjithfarë dukurish të jetës unë arrita të kuptoja...vendosa t’i ngrija sytë dhe të soditja mbarë rruzullimin. Në fillim e ndjeva veten ngushtë, sepse nuk merrja vesh çfarë është ajo që filozofët e quajnë kozmos: në çmënyrë ishte krijuar ky kozmos dhe kush ishte krijuesi i tij. Nuk dija gjithashtu ku e kishte ai zanafillën e vet dhe cili ishte qëllimi i tij i fundit. Zura të vrojtoja botën pjesë-pjesë, por kjo më bëri ta vrisja mendjen edhe më shumë, sepse shihja yjet e shpërndarë kuturu nëpër qiell, shihja diellin, dhe atëherë digjeshja nga dëshira, për të marrë vesh se çjanë tërë këto ... rrufeja që përshkon retë, gjëmimi që shpërthen me aq forcë, shiu, dëborë dhe breshëri - të gjitha këto ishin për mua një enigmë e pazgjidhëshme. ... vendosa t’i drejtohesha filozofëve ... pagova një shumë të mirë të hollash të mbaroja kursin e filozofisë ... ata ma mbushën kokën çdo ditë me teori të ndryshme, si atë mbi shkaqet e para e shkaqet e fundit,

sin dhe për mënyrën se si është ndërtuar ajo. Këta të fundit më habitnin më shumë se kushdo, për arësye se pranonin një Zot si krijues të gjithësisë, por nuk thoshin as nga kishte ardhur ky Zot, as se ku ndodhej ai, kur e krijoji botën, sepse nuk është e mundur të mendohet koha dhe hapësira para se të lindte gjithësia. ... Pa le pastaj sikur të dëgjoje çthoshin për idetë dhe elementet jo trupore, ose ato teoritë e tyre për fundësinë dhe pafundësinë! ... disa i vinin një kufi gjithësisë, ndërsa të tjerët e shihnin si të pa kufizuar. Një palë thoshin se ka një numër të madh botësh dhe i shanin ata që thoshin se ka vetëm një botë ... Sa për perënditë, as që është nevoja të flas, sepse disa e përfytyronin Zotin në formën e një numri ... disa më në fund i dëbonin të gjithë perënditë e tjera dhe ia jepnin qeverisjen e botës një Hyjnie të vetme ... disa të tjerë njihnin shumë zota dhe i ndanin këta në kategori, duke e quajtur njerin Zot të Parë dhe duke u caktuar të tjerëve vende të dyta e të treta sipas shkallës së hyjnisë së tyre. Veç kësaj, disa mendonin se Perendia nuk ka as trup, as formë, kurse të tjerët përkundrazi, thoshin se ka trup. Jo të gjithë filozofët ishin të mendimit se perënditë përzihen në punët e njerzve; disa i lironin zotat nga çdo lloj kujdesi, ashtu siç jemi mësuar në t’i lirojmë pleqtë nga detyrat shoqërore ... një pakicë shkonin edhe më tej dhe as që besonin të ketë perëndi, por e linin botën në mëshirën e fatit, pa prijës e pa sundimtar ...” Epikurianët nuk e mohanin ekzistencën e perendive, por mendonin se ato rrinë në hapësirën midis yjeve dhe nuk përzihen në punët e tokës ... filozofët arsyetojnë pse hëna nganjëherë merr formën e një gjysëm rrethi dhe pse formën e një drapri. Disa filozofë thonë se hëna është e banuar, disa të tjerë se është një paqyrë e varur mbi det ... Këto kohët e fundit thonë se edhe drita e hënës është e vjedhur, sepse vjen nga lart nga dielli ... se, vetë dielli është një lëmsh i zjarrtë prej metali të shkrirë...”

(shih, Lukiani, “Vepra të Zgjedhura”, përkth. shqip, 1979, fq. 36-40 e të tjera)

Lukiani përmbledhonte këtu shkrimtarë, dijetarë e filozofë si Homeri, Leukipi, Talesi, Anaksimandri, Anaksimeni, Platoni, Herodoti, Anaksagora, Demokriti, Herakliti, Pitagora, Sokrati, Epikuri, Krateti i Mallosit, Aristoteli, Empedokli, Eratosteni, Ptolemeu, Apollodori, Diodori i Siçilisë e të tjerë. Ai i kritikonte disa filozofë sepse ata nuk shpjegonin dot lëvizjen, si një veti e përvetshme e materies e të tjera. Me fantazi, madje edhe me një dozë ironie, “Volteri dhe Zhyl Verni i antikitetit”, Lukiani kishte shkruar edhe për “Rizbulimin e kontinentit Atlantida, në anën e kundërt të kontinentit tuaj sferik”, duke nënkuptuar kryesisht Platonin. Ai kishte shkruar edhe për fluturime në Hënë, në Qiell e nëpër tërë Galaksinë e banuar nga qenie njerëzore dhe nga gjithfarë qeniesh të tjera. Meqënëse paraqet mjaft interes dhe është e domosdoshme për shkrimin tonë, duke kërkuar pak ndjesë për citimin e gjatë, po e citoj me përzgjedhje: “... Shumë autorë po gënjejnë ... Injoranca ka fituar qytetarinë e nderit ... Unë, për vete mendoj se ky shkrim i imi ka për të qenë një lexim çlodhës, i bukur e i këndëshëm, këtu lexuesin do ta tërheqin jo vetëm veçantia e përmbajtjes dhe buku-



cili në një varg rastesh theu edhe dogmat e tabutë e lashta.

Herodoti, i pari, shkruante se në Afrikën veriperendimore ndodhen malet Atlas. Por, informatat më të rëndësishme e befasuese vijnë nga Platoni, i cili i referohej Solonit, i cili ishte bazuar në një informatë me prejardhje nga një prej priftërinjve të Egjiptit, që jetonte në Sais në deltën e Nilit. Platoni shkruante se, ai ishull gjigand Atlantida, përtej “Shtyllave të Herakliut” në Oqeanin Atlantik, ishte fundosur/gojë gjëllitur nga oqeani, nga një shpërthim kataklizëm vullkanik rreth nëntë mijë vjet më parë se koha e tij. Ky ishull na ishte nën dominimin e Poseidonit, Hyu i Detit dhe i Tërmeteve. Siç, mund të kuptohet, “Fundet e Tokës”, rezultoni vazhdimisht më tutje, kur njerzit

kolonive fenikase në brigjet e Gjibraltarit, si stacione lundrimi, pas më pas. Kështu pra mendohet se edhe vetë Platoni mund të ketë ekzagjeruar me atë datimin e para 9 mijë vjetëve, sepse një informacion i tillë ishte thuar se pamundur të ruhej i transmetuar gojarisht qysh nga koha kur nuk ekzistonte as shkrimi e as vetë civilizimi egjiptian. Studiuesit kanë vërtetuar se çfarëdo kataklizme nuk mund t’a fundoste e t’a zhdukte komplet një ishull të atillë gjigand, pavarësisht se mund të ketë pasur një kataklizmë vullkanike në një zonë të caktuar.

Sigurisht se kjo mitologji dhe “Bota qiellore sferike” njihet e studiohet edhe në shkollat e qyteteve tona antike.

“Rizbulimi i Atlantidës”

atomet, zbrazëtitrat, elementet, idetë e të tjera ata njerëz të ditur grindeshin me njëri-tjetrin lidhur me doktrinën e veta dhe kishin pikëpamje të ndryshme për të njëjtin send! ... Shpesh herë ata nuk ishin në gjendje të thoshin se, sa stadi është larg Megara nga Athina, e prapëseprapë dinin me saktësi çlargësi ndan hënë nga dielli; guxonin ta masnin atë me kut, përcaktonin trashësinë e ajrit, thellësinë e detit, periferinë e tokës, perimetrin, vizatonin rrathë, ndërtonin trekëndësha mbi katërkëndëshat, studionin gjithfarë sferash, madje edhe vetë qiellin. ... Para së gjithash, tek ata vërehet një ndryshim i plotë mendimesh lidhur me botën (universin): disa thonë se bota nuk është krijuar e as ka për t’u prishur ndonjëherë, kurse të tjerët guxojnë të flasin për krijue-

ria e idesë fillestare, jo vetëm larmia e trillimeve të paraqitura me një gjuhë bindëse e plot vërtetësi, por edhe fakti se çdo njeri nga tregimet përmban një aluzion të hollë për disa poetë, historianë dhe filozofë të lashtë, që kanë shkruar aq e aq gjëra të jashtzakonshme e të paqena; ... Unë, nuk iu vë shumë faj atyre që tregojnë të tilla përralla, sepse kam pasur rastin fatlum të shoh se me trillime merren edhe njerëz, të cilët siç thonë vetë, ia kushtojnë kohën vetëm filozofisë ... Unë, dua t'a përdor trillimin në një mënyrë më fisnike ... E vërtetë këtu është vetëm kjo, që gjithçka që do të tregoj këtu nuk i përgjigjet aspak të vërtetës ... Pra, do të shkruaj për gjëra që jo vetëm s'janë, por as që mund të jenë...

5. Mbasi u nisa me anije, kalova "Shtyllat e Herakliut" (mitologjia e fenikasve lundëtarë më përpara i kishte quajtur si "Shtyllat e Melkartit". (A.L.) dhe, me ndihmën e erës së mbarë, dola në Oqeanin Perëndimor (këtu, Oqeani Atlantik. (A.L.). Shkak për t'i hyrë këtij udhëtimi qenë pjesërisht kureshtja, pjesërisht dashuria e flaktë për çdo gjë të jashtzakonshme si dhe dëshira për të parë se ku mbaronte Oqeani e çlloj njerëzish rronin matanë. Prandaj, pasi ngarkova një sasi të madhe ushqimesh dhe uji, mblodha pesëdhjetë veta që afroreshin në mendime me mua, grumbullova gjithfarë armësh, pajtova timonierin më të mirë dhe e paisa anijen time - anije e lehtë dhe e shpejtë - me çdo gjë që nevojitej për një lundrim të gjatë e të rrezikshëm.

(Në të njejtën temë, pak më poshtë, por, në sferat qiellore Lukiani shprehet: "... Pas tij gjendet ujëdhësa e Kalipsosë. Pasi të kalosh tërë këta ishuj, do të arrish në një kontinent të madh, që është në anën e përkundërt të kontinentit ku jetoni ju. Atje ti do të heqësh shumë të zeza; do të shtegëtosh midis gjithfarë popujve dhe, mbasi të jetosh ca kohë në mes të njerëzve të egër, do të sosësh më në fund në kontinentin tjetër...)

6. Tërë ditën dhe natën lundruam me erë të mbarë dhe, për sa kohë që dukej së largu toka, velëzuam qetë-qetë. Mirëpo të nesërmen, pasi lindi dielli, u ngrit një erë e marrë, deti zuri të trazohej, pllakosi errësira dhe ne nuk mundëm kurrsesi t'i ulnim velat. Të mbetur në mëshirë të erërave, kaluam mes rreziqeve plot shtatëdhjetë e nëntë ditë, kurse të tetëdhjetën, me të dalë dielli, pamë jo larg nesh një ishull të lartë, të veshur krejt me pyll ... kur u ngritëm zgjodhëm tridhjetë veta për të ruajtur anijen, kurse njëzet të tjerët i mora me vete për të parë ishullin.

7. Pasi bëmë nja tre stade udhë, nga bregdeti në pyll, pamë një shtyllë bronzi me një mbishkrim, që ishte pothuajse i shuar dhe që thoshte: "Deri këtu arritën Herakliu dhe Dionis!" Atje afër mbi disa shkëmbinj pamë edhe dy gjurmë këmbësh, njera me madhësi sa një pletër e Herakliut dhe tjetra më e vogël e Dionisit...

8. Sa kaluam lumin në va ... hasëm në disa qenie njerëzore, disa gra amazona gjysëm njerëz gjysëm hardhia ... ato na përshëndetën ... disa prej tyre flisnin lidishtë, të tjera indisht, kurse shumica greqisht...

9. Rreth mesditës, shpërtheu befaz një tufan, që e ngriti anijen tonë përpjetë nja tri mijë stade, duke e sjellë rrotull pezull

në ajër. Era rrihte velat e anijes dhe duke i fryrë ato, na shtyu tej e më tej.

10. Plot shtatë ditë e shtatë netë lundruam në ajër, të tetën ditë pamë në ajër një tokë të madhe, që dukej si ndonjë ishull vezullues në formë sferë dhe që lëshonte një dritë të fortë. ... Poshtë pamë një sferë tjetër, ku kishte qytete dhe lumenj, dete, pyje dhe male. Atëherë e morëm me mend se përfund nesh ndodhej ajo Toka ku ne banojmë.

11. Vendosëm të shkonim më tej ... kur pamë disa kuaj-skifterë-shqiponja ... pasi na kapën na shpunë te Mbreti. Kur, na pa dhe na njohu siç duket nga mënyra e veshjes, na pyeti: "Grekë jeni ju o të huaj?" Ne iu përgjigëm me "po" dhe ia treguam tërë punën ... dhe ai na tregoi historinë e vet ... Dhe ky vend, - tha ai - nuk është tjetër veçse Hëna, e cila ju ndrin juve që banoni atje poshtë..."

12. "Po të më ecë fati në luftën, që do t'u hap banorëve të Diellit dhe mbretit të saj Faetonit (Dielli është i banuar siç është edhe Hëna), do të rroni tek unë me tërë të mirat. ... Nesër do t'ia nisim fushatë s..."

14. ... erdhën edhe forca aleate për të dyja palët ...

16. ... Faetonit i erdhën për ndihmë banorët e Siriusit ... u vonuan hobetarët e Kashtës së Kumtrit dhe Re Centaurët ...

19. Mbretëria e Diellit e fitoi luftën ... ata vendosën të ndërtonin një mur në ajër me qëllim që asnjë rreze dielli të mos binte në Hënë, ky mur i dyfishtë përbëhej prej reshë ... Kështu Hëna u errësua në një natë të përhershme ...

20. "Banorët e Diellit bashkë me aleatët e vet vendosën të bëjnë paqe me banuesit e Hënës dhe aleatët me këto kushte: ... ta shëmbin murin, që i pengonte dritën Hënës ...

22. Tani dua të flas, për gjithçka të re dhe të jashtzakonshme që pamë në Hënë ... Së pari, fëmijët atje lindnin jo nga gratë, por nga burrat. Martesat bëheshin midis burrave dhe fjala "grua" nuk njihet fare. Deri në moshën 25 vjeç banori i Hënës, ishte si grua dhe e çonin te burri, kurse pas kësaj moshe ai merrte vetë për grua një burrë. Fëmijët ata i rritnin jo në bark, por në pulpë ...

23. Kur plaket njeriu, nuk vdes, por tretet si tymi, bëhet ajër ...

26. Në pallatin e mbretit pashë edhe një send tjetër të çuditshëm: një pus jo shumë të thellë, mbuluar me një pasqyrë të madhe. Po të zbresësh në këtë pus mund të dëgjosh gjithçka flitet në tokën tonë. Dhe po të vështrosh në atë pasqyrë, do të shohësh gjithë qytetet dhe popujt, sikur t'i kishe përpara syve. (Vini re: një lloj përgjuesi dhe një lloj teleskopi filmues A.L.) Unë pashë me të vërtetë të afërmit e mij dhe tërë atdheun; nëse më kanë parë edhe ata nuk mund të them asgjë me siguri. Kush të mos besojë, le të vejë vetë atje t'a verifikojë ...

45. Pas një farë kohe, në ujë u dukën peshq dhe përreth nesh zunë të fluturonin zog - shenja këto që tregonin se aty afër kishte tokë ...

47. ... Të nesërmen kur zbardi dita, pamë Tokë dhe atëherë menduam se ky do të ishte kontinenti, që ndodhej në anën e përkundërt të kontinentit tone ...

Nuk ka asnjë dyshim se Lukiani i kishte njohur shkrimet e dijetarëve gjenialë helenë dhe më konkretisht disa nga shkri-

met e Platonit, Talesit dhe Eratostenit. Eratosteni (shekulli III p.e.r.), mbi bazën e gjatësisë Aleksandri-Asuan, që ishte një rrugë lumore e Nilit e matur, mbi bazën e këndit të rrezes diellore, në një pus në Aleksandri (në Asuan në ekuator, në mesditë, rrezja binte pingul mbi pus) dhe të formulave të gjeometrisë euklidiane të harkut dhe të kordës, përcaktoi perimetrin e globit tokësor, me një gabim precizioni shumë të vogël, duke pasur parasysh edhe metodën primitive nga këndvështrimi i sotëm modern, por që ishte gjeniale për atë kohë!

Ndërkaq, ironia e fatit dhe e koincencës luajti me vetë fantazistin Lukian. Rezultoi se fantazia e tij, për një tokë kontinent në hemisferën perëndimore, ishte vërtetë një realitet dhe ju ndërkohë mendoni pak sikur ai të kishte shkruar me idenë e profetit dhe të mashtruesit! Lukiani, me fantazi rizbuloi jo vetëm Atlantidën, por u nis nga ai kontinent edhe për në Hënë. Ai, Zhyl Verni antik, ishte i pari që dashje pa dashje e profetizoi nisjen për në hënë nga ai kontinent, siç e dimë se me anijen Apollo dhe me modulën "Shqiponja" u arrit zbritja në hënë...

Atje ku dy detet puqen dhe kanë ndarje një pengesë që nuk e kapërcejnë dot?!

Në Kuran shkruhet: "Ne, edhe ty ta zbritëm Librin e vërtetë, që është vërtetuesi i librave të mëparshme dhe garantuesi i tyre" (El Maide, 48)

Ja një nga këto vërtetim-garantime, te Libri i Jobit, shkruhet: "Hyji pa ndihmë të kujt e shtrin/zgjeron Qiellin.../ Ai krijoi Arushë e Orion, Shenjëzat e Yjet e jugut/ Shtrin veriun përmbi zbrazti/ e mban Tokën varur prej asgjëje.../ Dora e tij shpon sh'ligë fluturuesen/ Cak rrethues u vuri ujrave/ N'kufi t'dritës e terrësirës/ Në shkrofsha n'lindje Ai s'do të më dëftohet/ as në Perëndim s'do ta takoja/, majtë-jug n'u sjellsha, askund s'do ta ndeshja/ nëse marr djathtas-veri, syri s'do të ma shohë..." (Cit me përzgjedhje "Bibla", bot. 1994, "Libri i Jobit", fq. 623-657)

Në Kur'an-i shkruhet: "Ne me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë" (Edh Dharijatë, 47); "Ai është që krijoi natën e ditën, diellin e hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë" (Suria El Enbija, 33). "Ai krijoi qiejt e tokën me qëllim të caktuar; Ai natën ia mbështjell (vendit të) ditës dhe ditën ia mbështjell natës..." (Ez Zumer, 5; shën me *, fq. 638); "Dhe i sheh kodrat e mendon se ato janë të pa lëvizëshme, ndërsa ato ecin sikurse ecin retë" . (En Neml, 88, flitet për rrotullimin e tokës);

Dhe të vijmë te tema konkrete. Në Kuran, në disa ajete shkruhet se "All'lahu është Zot i Lindjes dhe i Perëndimit të Tokës" (El Muzemil, 9 e të tjera). Në kuptimin e vështrimit e parë, si kordinata gjeografike, kjo do të kuptohej si një lindje e një perëndim. Por ja ku gjendet edhe një çështje mjaft enigmatike, në Suren Er Rrahman, Ajeti 17, ku shkruhet e flitet "për dy lindje dhe dy perëndime!" Po e citojmë edhe disi më të plotë tekstin e Sures: "5. Dielli dhe Hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë"; 16. E cilën begati të All'lahut ju e mohoni?; 17. Zot i dy Lindjeve dhe i dy Perëndimeve"; 18. E cilën të mirë të All'lahut tuaj ju e mohoni?; "19. Ai i lejoi dy detet të puqen ndërmjet vete"; 20. Ndërmjet atyre të dyve është

një pengues që ata të dy nuk e kapërcejnë"; 21. E cilën të mirë të All'lahut tuaj ju po e mohoni?; 22. Prej atyre të dyve nxirren margaritarë e diamantë; 23. E cilën të mirë të All'lahut tuaj po e mohoni?; 24. Dhe të Atij janë anijet lundruese të ngritura lart si kodra në det.; 25. E cilën të mirë të All'lahut tuaj po e mohoni?; 26. Çdo gjë që është në të është e zhdukur.; 33. O turmë e xhinëve dhe e njerzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve dhe të tokës, depërtoni pra, po nuk mundeni vetëm me ndonjë fuqi të fortë". (Duke shmangur forcën e gravitetit?!)

Edhe në Suren "El Mearixh, 40, shkruhet: "40. Pra betohem në Zotin e lindjeve e të perëndimeve, se Ne kemi fuqi" dhe gjithashtu në Suren En Neml, 61: "... dhe në mes të dy deteve bëri ndarje".

Atëhere ku duhet t'a kërkojmë këtë vend me një ndarje midis dy deteve?! Në Suren El Kehf, ajeti 61, shkruhet edhe për një tjetër rrip toke ndarës, si vendafrim detesh, i cili sipas kontekstit dhe interpretuesit kuptohet qartë se janë Deti i Kuq dhe Deti Mesdhe, domethënë rripi tokësor i Suezit. Ky identifikim përforcohet edhe nga fakti se tregimi aty lidhet konkretisht edhe me Moisiun/Musanë dhe me disa rrugë këmbësore e karvanesh të njohura. Realisht pozicioni i dy këtyre deteve nuk bie lindje-perëndim, por vetë rripi i tokës, si meridian, sa duket shënon te një lloj ish kufiri ndarës midis lindjes dhe perëndimit të vetë Orjentit, ku lidhet edhe Azia me Afrikën.

Ndërkaq duhet të vërejmë se në Suren Er Rrahman, nuk ka ndonjë shënim e interpretim identifikim për këtë vendtakim detesh! Sikur t'a mendonim se edhe këtu, flitet për rripin e Suezit, vërehet se aty nuk ka asgjë që të lidhet sadopak me Moisiun e me pasuritë minerare! Duke pasur parasysh përshkrimin dhe rastin se sa vendtakime të tilla ka në globin tokësor, ekziston mundësia se për rripin e dy lindjeve dhe dy perëndimeve bëhet fjalë për rripin e tokës midis dy nënkontinenteve amerikane, aty ku kufizohen dy Oqeanet dhe nënkuptohet edhe tërë hapsira tokësore e hemisferës perëndimore. Por, mbetet për t'u përcaktuar se nga mund të ishte konstatuar ky kontinent: nga lartësia qiellore dhe i zbritur si informacion hyjnor, apo nga mitologji të popujve të hershëm dhe nga libra fantastikë të dijetarëve antikë (Talesi, Platoni, Lukiani etj), sigurisht edhe nga informacione të lundëtarëve antikë, që orjentoreshin me shenja dhe me anë të yjeve?! (Shih En Nahl, 14-16; 24)

Dihet dhe duhet të vërejmë këtu, se antikët i kishin studiuar disa veti që vëreheshin tek sferat dhe kjo do të thoshte se konceptet e koordinatave gjeografike, ndryshonin edhe në vartësi të lëvizjes rrotullimit, pozicionit e të tjera. Tek sfera, një perëndim ka një perëndim tjetër dhe për vehte bëhet lindje e anasjelltas siç edhe tek jug-veri dhe kjo ide tek dijetarët e në mitologji ka ekzistuar.

Por, duhet pranuar se Kurani ka sjellur edhe vërtetime, garantime e magazinime të arritjeve të jashtzakonshme të vetë popujve arabë, siç duket se ishte edhe kuptimi tjetër se globi ka dy lindje dhe perëndime diellore e hënore në të dy hemisferat.

SAKRIFICA DHE SUKSESI I SHALIANIT TONIN LOGU

Gjatë vizitës time në NEW YORK, pata kënaqësinë të takoj një mik timin të kamotshëm, ish studentin kurajoz të viteve 90-të, Tonin Logun!

Tonini ose Toni, si zakonisht e thërrasin, është nga fshati Lekajt i krahinës së Shalës, rrjedh nga një familje me tradita të shquara atdhetare siç është ajo e Vocërr Balës së Shalës, për të cilin Fishta i Madh në veprën e tij, "Lahuta e Malcisë", shkruan:

*Tre dragoj i kish pas Shala
Ish ma i forti Vocërr Bala
Vocërr Bala lshon një zá
Sot kulshedrën duhet me ngá
Se malet bashkë po don me i bá
E zani i Shal's nuk ndihet má*

-Daja i babës së tij, Dede Lulashi i Lotajve, ishte një ndër udhëheqësit e shquar të Djelmnis së Shalës.

-Kushëri i Tonit, Nike Marashi, për veprimtari atdhetare, në mbrojtje të vlerave kombëtare shqiptare, u dënua me vdekje nga UDB-ja Jugosllave.

E pra, Tonini, si një trashëgues dinjitoz i vlerave të truallit dhe të gjakut të tij, nuk kishte se si të ishte ndryshe, i zgjuar, trim e kurajoz deri në vetëmohim për tu përballur me regjimin komunist të kohës.

Mbaron shkollën e mesme në vitin 1985, në shkollën e mesme " Mehmet Shpendi", Breg Lumi, Shalë, me rezultate shumë të mira.

Në shtator të 1986-ës, vazhdon studimet parauniversitare pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Tiranë dhe në vitin 1987, vijon studimet universitare në Fakultetin e Inxhinieris Pyjore në ILB Kamëz.

Në fillimvitin 1990, përfshihet fuqishëm në lëvizjen studentore të kohës.

Për shkak të kësaj përfshirje dhe të natyrës së tij rebelë dhe kundërshtuese ndaj regjimit të kohës, fillon përndjekja brutale ndaj tij.

Pas mbarimit të vitit shkollor, në korrik 1990, shkon pranë familjes së tij. Dhe vjen Gushti i vitit 1990.

Tonini, ndonëse kishte edhe dy vite pa përfunduar studimet e larta, si shumë shqiptarë të tjerë, vendos të largohet nga Shqipëria për në vendin e Lirisë, USA.

Ky moment tregohet me shumë dhimbje dhe trishtim nga Toni:

"_Me shumë dhimbje vendosa ta lë vendin tim. Nuk i tregova fare familjes, ju thash do shkoj në Shkodër.

Nga Shala jam nis me 22 gusht 1990 dhe kam arrit në Vuthaj me 25 gusht. Tre ditë tmerr që nuk do ti harroj kurrë.

Rrugës për në Vuthaj kam kalua tri posta kufitare, atë të Rrogamit (Valbonës), të Thethit dhe atë Jugosllave".

Dhe Toni, vazhdon:

"Isha vetë i dytë, betimi ynë ishte: Kufiri do kalohej i gjallë apo i vdekur. Kthim mbrapa nuk kishte.

Dorëzimi i gjallë në duart e kufitarëve

tanë ishte i paimagjinueshëm, sepse fundi dihej.

Nisim ngjitjen, për në Qafë të Pejës, asnjëherë në jetën time nuk e kisha shkel këtë rrugë. Terreni ishte alpin, shumë i

humbur orientimin.

Na ishte mbaru edhe ata pak ushqim që kishim marrë me veti. Kullotat ishin të mbushura me çoban të kooperativës, që ishin po aq të rrezikshëm sa ushtarët



vështirë, nuk kishte tela me gjemba apo ndonjë shenjë dalluese, ndërshtetnore.

Kemi kalua postën kufitare në Rragam dhe pastaj humbëm rrugën. Tre ditë dhe tre netë humbje kohe dhe sorollatje nëpër Alpe nga që nuk e njihja zonën dhe kisha

e postës.

Piramidën ndarëse nuk e shihnim askund(mbase e kishim anashkaluar)". Vijuam ecjen mes ankthit dhe frikës se, kur do kërciste pushka mbi ne.

Pas një rraskapitje tre ditë dhe netë u



Tonin Logu e Gjovalin Progni

gjendën përballë postës kufitare Qafë Pejë.

"Pozicioni i ushtarëve-kufitar nuk dihej, në çdo moment mund të dëgjonim parullën e tmerrshme – "Ndal - e shoqëruar me të shtëna automatiku!"

Dhe kështu, Zoti i ndihmoi dhe natën e 25 Gushtit, kalojnë Qafën e Pejës, të rraskapitur nga lodhja, stresi dhe mërzia e pamatë.

Në një moment, tregon Tonini: "Frika e përballjes me ushtarët e postës së policisë ishte shumë e madhe.

Me shumë kujdes i anashkaluam e vijuam ecjen dhe pas disa minutash gjetëm disa ambalazhe dhe kuti konservash të gjuajtura prej policëve kufitar në tokë. Nga shkrimi që mbanin e kuptuam që kishim kaluar kufirin.

Ishte një ndjenjë e çuditshme, gëzim dhe trishtim njëherësh, pasi dolëm në një botë tjetër, të panjohur për ne".

Vijuam rrugë, pa ditë se ku do dilnim dhe pas një ore arritëm tek shpija e parë në Vuthaj...

Dhe Toni, vazhdon:

"U gjendem ne oborrin e shtëpisë së Musli Bajraktarit të Vuthajve. Sapo ju prezantuam, na ofroi bukë dhe çdo gjë të nevojshme për momentin si dhe na bani me dije se, duhet të paraqitemi patjetër në postën kufitare jugosllave që ishte aty pranë.

Dhe ne, ashtu vepruam, të shoqëruar nga Muslia, u paraqitëm në postën kufitare të Vuthajve. Gjej rastin ta falënderoj për zemërsisht, zotin Musli Bajraktari, për ndihmën e ofruar".

Nga aty, Toninin me gjithë mikun e tij i dërgojnë në postën e policisë në Plavë. "Përkthyes, -kujton Toni, ishte Zenel Qosja, një njohës i mirë i terrenit dhe i realitetit shqiptar. Nuk mund të le pa

përmendur, rolin pozitiv të Komandantit të Postës, një djalë i mrekullueshëm nga Kroacia".

Dy ditë më pas i dërgojnë në Gjykatën e Plavës, nga e cila morën dënimin me 30 ditë burg, të cilin e kryen në burgun e Spuzhës së Malit të Zi. Mbas kryerjes së dënimit 30 ditor, u transferuan në Beograd, në kampin e refugjatëve politik, nën mbikëqyrjen e OKB-së, Padinska Skela, ku qëndruan dy javë. Mbas një procesi të gjatë verifikimesh, pasi shteti shqiptar kishte dhënë informacione të shumta për Toninin, si kundërshtar i regjimit, proces që zgjati dy javë, morën Statusin e Refugjatit Politik, si dhe ju garantua udhëtimi për në USA.

Ne USA, sapo u sistemua dhe u pajis me dokumentacionin e nevojshëm, Toni, vijoi studimet në Inxhinieri. Pas mbarimit të studimeve me rezultate të shkëlqyera, vijoi punën në profesionin e tij të preferuar. Deri sot ka arritur të përfundojë mbi 13 projekte të rëndësishme inxhinierike si inxhinier konsulent dhe menaxher.

Vazhdimisht bëhet pjesë e veprimtarive të ndryshme atdhetare-patriotike, që organizohen në New York e vende të tjera në USA.

Me miq dhe personazhe si Tonin Logu, krenohet çdo shqiptar.

Nga Gjovalin PROGNI

*** Poezi nga Mevlud Buci *** Poezi nga Mevlud Buci ***

DRITË E KËNGËS TIME*-Dukagjini-*

Dukagjin, o dritë e lirisë,
Dukagjin, o bedene arbërore,
Dukagjin, vendi i trimërisë,
Je ti shpirti, je diellkurorë...

Dukagjin, me plot bijë e bija,
Dukagjin, o këngë e zemrës,
Dukagjin, ti je dritëlibrie,
Je si Korabi e mali Benës...

Dukagjin, o tokë e bardhë,
Dukagjin, o dritë vetëtime,
Në pesë breza me babë e djalë,
Ti je dritë e këngës time...

BINJAK ME SHQIPONJËN*-Poetit, filozofit, Preç Zogaj-*

Ja njoh vargjet, shpirtin e lirisë,
Ja njoh zemrën-gurrë e bardhësisë,
Ja dëgjoj zërin, atë zë kushtrimtar,
O Preç Zogaj, o lezhjan thesar.

Ai flet me zërin e dritëbekimit,
Ai thur vargjet e dritë shenjtërimit,
Ai ka ortak malin, detin dhe kurorën,
Poeti Preç Zogaj, binjak me shqiponjën.

DRITËSIM

Zëri ka dritën,
Shpirti ka jetën,
Provat kanë meritën,
Shembulli ka t'vërtetën.

Mirësia mbjell mirësinë,
Gënjeshtra zë batakun.
Guximi ka trimërinë,
Liria vëlla ka zambakun.

Krenaria ka shkëlqimin,
E drejta ka lavdinë,
Mosmirënjohja ka zhgënjimin,
Ligësia ka fundfundësinë.

Çdo shpirt ka bardhësi,
Kur prezanton dritë.
Më e shenjta bukuri,
Kur dritëson meritë.

PENËN DRITË*-Kushtuar poetit brilant lezhjan, Ndue Dragushës-*

E thotë mali e fusha,
Ku të kam, Ndue Dragusha?
Runja ime vali e shkrepit,
Thotë: Në Lezhë rron poeti.

Vargje drite, vargje hynie,
Plot me mall e dritë lirie.
Thonë kështjellat, male e fusha,
Penën dritë, Ndue Dragusha!

DRITË E BEKIMIT...*-Kushtuar poetit Dukagjinas, Lulash Brigja-*

Faleminderit të çon Korabi,
Runja ime me shkrepë e grixha,
O penartë, o shpirtbehari,
Ku të kam, o Lulash Brigja?!

Ta puth penën me syt'zembrës,
Ta prek ballin me fllad Drini,
Je si Runja e si mali i Benës,
O i urti, bir Dukagjini.

N'kohëra e mote nëpër brezni,
Do të nderojnë brezat e Dukagjinit,
O poeti me dritë liri,
Lulash Brigja, dritë e bekimit.

RREZATON LISSALBA

Ku ka si fjala e lirë?
Ku ka si puna e mirë?
Ku ka si dritë e sinqeritetit?
Ku ka si lulbuli i shkrepit?
Ku ka si zallimim me valë?
Ku ka si më e urta fjalë?
Ku ka si Korabi e si Taraba,
N'shekuj rrezaton Lissalba.

DJEPI

Pas 9-të motrave linda unë
Për jetën, kohën e fisin.
Prindërit e mi çanë në fortunë,
Ma kishin lënë emrin Mevlud.

Nëna ime shumë fisnike, te vatra,
E vuajtur nën Runjen, tek shkrepit,
Me shpirt hyjnor më rriti tek vatra,
Me plot këngë e ninulla djepi.

Dhe unë, me shpirtin bosh, si zalli,
Dhe unë, i rritur nën Runje, tek shkrepit,
Për kohën e brezat kam dallgë malli,
O njerëz, kurrë s'do harruar djepi.

I PËRFALËM SKËNDERBEUT

E kam zemrën qelibar,
E kam shpirtin si thesar,
E kam këngën dritë vetëtime,
Mal e kam unë krenarinë.

E kam forcën si dallgë deti,
E kam qëndresën porsit shkrepit,
E kam zërin, zë kushtrimi,
Bash si Buna, bash si Drini.

I kam shokët dritë në sy,
E kam genin dritëbardhësi,
Jam si lis, si lis kurorë,
Nuk më mposht asnjë provokatorë.

I kam rrënjët tek lisanja,
E lëshojzërin tek ograja,

E puth token, plisat e dheut,
I përfalëm Skënderbeut.

DRITË FRAN GJOKA...

A e lexon si i këndon pena,
A e kupton si i jehon zemra,
A e njeh si është mali e shkrepit,
A e vëren se kush është deti?
A e ndjen peshën që ka qielli e toka?
Dritë Ishull-Lezha, dritë Fran Gjoka.


BËJNË PABESITË*-Boshët-*

Ata flasin, flasin, flasin e flasin,
Ata pëllasin, pëllasin, pëllasin e pëllasin,
Ata zhurmojnë, zhurmojnë e zhurmojnë,
Ata për poezitë flijohen, luftojnë, luftojnë.

Ata bëjnë ortakëri, ortakëri, ortakëri, ortakëri,
Ata grinden, grinden e grinden për demokraci,
Ata i bëjnë gropën e puçin shoku-shokut,
Ata stërnipa të lanetit, stërnipa të Bllokut.

Ata hiqen hyjnorë, të drejtë, zemërdritë,
Ata që janë joge, tartufë e të korit,
Ata hiqen të thjeshtë, urtësi e vërteta,
Ata që me treftyrësi i ka damkosur jeta.

Ata e kanë në gojë bujën, premtimin,
E kanë në shpirt zilinë, zhgënjimin.
Ata hiqen madhështorë si kollosët,
O njerëz të Zotit, ruhuni nga Boshët!

**REDAKSIA**

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin

MIKEL KOPSAJ, Administratori i
Njësisë Administrative Shalë

